



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 71/37/2023

Në bazë të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale numër Nr. 03/L-40 neni 43, nenit 31 të Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, bëjë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e tetë -VIII- të rregullt për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet me datë 31.08.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.
3. Rregullore për taksa komunale për vitin 2024.
4. Kërkesë për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.
5. Plotësim ndryshimi i vendimit me numër 01/Nr.4957/2023 për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.
6. Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.
7. Informatë për korrje shirjet.
8. Të ndryshme.

Bashkë me ftesën ju dërgojmë:-

- Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.
- Materialin e raportit të punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2023.
- Materialin e rregullores për taksa komunale për vitin 2024.
- Materialin e kërkesës për shqyrtimin e aktit për vendimin me numër 01/5269/2023.
- Materialin e plotësimit ndryshimit të vendimit me numër 01/Nr.4957/2023 për rialokim të mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale.
- Materialin e informatës mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2022-2023.
- Materialin e informatës për korrje shirjet.

Hani i Elezit
Data:-22.08.2023

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7133/2023
Data: 22.08.2023

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e shtatë -VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.07.2023 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: **Mehmet Ballazhi** (Kryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve të NPL Pastrimi), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se mungon një anëtarë i Kuvendit të Komunës (znj. Hyriete Isufi).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023.
3. Plotësim-ndryshim i vendimit me numër 01/Nr. 5011/2023 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2020, 2021 dhe 2022 në vitin 2023".
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
5. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2023.
6. Informatë për sektorin e emergjencave.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUAR PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti i miratuar për vitin fiskal 2023 është në shumë prej 3,349,715.00 €, në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 960,996.65 € apo 56.43%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 177,869.89 € apo 38.25%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 35,558.54 € apo 36.85%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 57,258.08 € apo 57.25%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 29,439.15 € apo 2.98%. Totali i shpenzimit për periudhën Janar – Qershor të vitit 2023 është në shumë prej 1,261,122.61 € apo 37.64%. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 165,032.38 € të hyra vetanake për periudhën Janar-Qershor 2023 të planit të të hyrave vetanake.

Ajnure Thaçi thekson:- çka ka ndikuar që kemi shpenzime kapitale në shumë prej 2.98 % . Në faqe dhjetë keni potencuar subvencionet , kërkoj sqarim se kush është subvencionuar për shkak se po që se krahasohet me vitin paraprak kemi një diferencë të subvencioneve.

Lindita Ballazhi thekson:- për investimet kapitale drejtoritë përgjegjëse mund të japin informacion se deri ku janë zhvilluar procedurat, ndërsa për çështje të subvencioneve do tu a përcjelli materialin me shkrim.

Sherif Berisha thekson:- cili është buxheti final aktual nga buxheti i miratuar dhe sa është dallimi i buxhetit sipas Ligjit të Buxhetit me atë aktual. Sa është shuma e rritjes nëse keni pasur rritje. A ka rritje nga Ministrinë apo nga donacionet. Te shpenzimet e pagave shihet që ka një përqindje prej 56.43 % që do të thotë se ka një mbi shpenzim dhe nëse vazhdohet me këtë ritëm i bien që në muajin nëntor dhe dhjetorë do të mbesim pa paga. Te mallrat dhe shërbimet nuk e dimë se çfarë shpenzime janë shpenzuar për kodin 13460 . Shërbime kontraktuese shihet që është rritur shuma nga 6543.62 € në 29339.92 € që në të njëjtën periudhë shpenzimi në përqindje i bien 348 %. Shpenzimet për ushqim dhe pije janë rritur në 113% , shpenzimet për karburante janë rritur në 226 % që do të thotë që veturat nëpër shtëpia po ju shkojnë të gjithë drejtorëve. Shpenzimet e pastrimit janë rritur në 226 % . Mirëmbajtja e ndërtesave është rritur për 320 % . Shpenzimet e telefoisë mobile janë rritur 54.9 % . Shpenzimet e drekave zyrtare janë ngritur për 42 % . Te subvencionet dhe transferet çfarë shpenzime janë bërë në kuadër të kodit 21200. Te kategoritë e shpenzimeve kapitale keni shpenzuar 3 % të buxhetit që shihet që është një menaxhim jo i mirë për këtë gjashtë mujorë.

Lindita Ballazhi thekson:- nuk është e vërtetë që në raport nuk është cekur se sa është buxheti fillestar apo në bazë të ligjit të buxhetit si dhe buxheti final. Në faqe tre e kemi buxhetin në bazë të ligjit të buxhetit, pastaj vijon faqja pesë që këtu e kemi buxhetin edhe në bazë të ligjit të buxhetit, në bazë të hyrave vetanake, financimin prej granteve , të hyrat vetanake komunal dhe i keni të gjitha shtimet e buxhetit që ka ndodhur në bazë të granteve të tjera të jashtme siç mund ta shihni në faqen shtatë ma saktësisht që kemi grante të cilat janë të bartura vit pas viti si dhe Unioni Evropian një pjesë që ka mbetur prej këtij donacioni si dhe nga Qeveria Japoneze që do të thotë buxhetin me gjithë këto grante e keni në faqe shtatë. Dallimi në bazë të ligjit të buxhetit dhe buxhetit finalë është 48 713.48 € dhe këtu kanë ndikuar donacionet që i potencova. Sa i përket kategorisë së pagave dhe shtesave buxheti planifikohet një vit përpara dhe miratohet në muajin shtatorë të vitit vijues për vitin e ardhshëm dhe me buxhetin me të cilin ne operojmë është miratuar në kuvend komunal në vitin 2022 në muajin shtatorë. Në momentin që ne e kemi planifikuar buxhetin për kategorinë paga dhe shtesa e kemi planifikuar në bazë të koeficienteve dhe pagave aktuale dhe ligji i ri i pagave ka hyrë në fuqi në muajin shkurtë të vitit aktual dhe planifikimi për këtë kategori ishte në bazë të ligjit të vjetër të pagave. Me ligjin e ri të pagave ka disa ngritje për shumicën e pozitave dhe kjo ka ndikuar që 56 % të shpenzohet buxheti për këtë kategori dhe si komunë nuk mbajmë përgjegjësi nëse do të ketë mungesë të mjeteve në këtë kategori sepse normalisht duhet që qeveria t'i mbulojë nëse kemi mungesë të mjeteve. Në krahasim me vitin e kaluar janë zhvilluar më shumë aktivitete dhe ka ndikuar edhe rritja enorme e çmimeve por për momentin nuk i kam të gjitha informacionet të cilat i keni kërkuar por do tu a përcjell me shkrim.

Mehmet Ballazhi thekson:- më tridhjetë shtatorë në vitin e kaluar është miratuar buxheti në Kuvendin e Komunës, e ligj të ri të pagave nuk ka pasur dhe nuk ka pasur ndonjë paralajmërim se si do të jenë pagat me Ligj të ri dhe është çështje e Qeverisë çështja e pagave . Ju e dini që Qeveria Japoneze na i ka dërguar mjetet në muajin dhjetorë të vitit të kaluar dhe nuk ka kur far mundësi që brenda një muaji me i zhvilluar procedurat për me i shpenzuar ato mjete. Jemi në fund të muajit korrik dhe mjetet financiare janë të zotuar por nuk janë të shpenzuara por në raportin e kryetarit të komunës do të jenë të paraqitura. Është mirë me u sqaruar për shpenzimet se ku janë shpenzuar por me u paragjykuar është keq dhe nëse është keqpërdorë duhet ta potenconi që ky kodë buxhetorë me këto mjete është keqpërdorë në këto vende dhe është mirë që të potenconi se cilit drejtori i ka shkuar vetura te shtëpia dhe është mirë të specifikohet . Në këtë vit është marr vendim në kuvend për festivalin në shumë prej 18,500.00 € që i ka rrit shpenzimet dhe kur ka dinamizëm rriten ushqimet, shpenzimet e derivateve , shpenzimet për mallra dhe shërbime që do të thotë që rriten të gjitha këto për shkak të aktiviteteve që i bëjmë. Te shpenzimet kapitale ende nuk janë kryer pagesat.

Refet Kalisi thekson:- furnizimi me ushqim dhe pije a përfshihet ushqimi apo vetëm pijet për shkak se është një shumë e madhe në krahasim me vitin e kaluar. Është potencuar qiraja për makineri, kërkoj sqarim. Te projektet kapitale që janë përfshirë shtrimi me kupëza në të gjitha fshatrat është e njëjta edhe tash por është mirë me i definuar . Muret mbrojtëse e di që kemi pasur problem në Lagje të re por nuk është dashur të ceken në të gjitha fshatrat por të specifikohet.

Lindita Ballazhi thekson:- kodi 13620 është furnizim me ushqim dhe pije dhe ky shpenzime ka të bëjë me shpenzimet e bifesë dhe të çerdhes. Është qiraja për veturën për nevojat e administratës komunale dhe QKMF-së.

Mehmet Ballazhi thekson:-jemi të detyruar me i përmendë për shkak se na del problem nëse dum me bërë një mur mbrojtës nëse nuk e kemi të përfshirë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RAPORTI FINACIARË PËR PERIUdhËN JANAR- QERSHOR

3. Plotësim-ndryshim i vendimit me numër 01/Nr. 5011/2023 për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga viti 2020, 2021 dhe 2022 në vitin 2023".

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- Ministria e Financave ka marr vendim për me i bartur të hyrat jo vetëm të viti 2022 por edhe të viteve paraprake dhe kemi mjete financiare të cilat kanë mbetur të pa shpenzuara që nga viti 2020 dhe 2021 dhe dallimi është në shumë prej 10,252. 04 €. Në material i keni të specifikuar në detale.

Sherif Berisha thekson:-bartja e të hyrave është bërë tri herë në muajin shkurt , në muajin qershor dhe në muajin korrik dhe na tregoni shumën e të hyrave për vite të ndara për vitin 2020, 2021 dhe 2022 sepse bartja e të hyrave bëhte nga viti 2021 dhe 2022 për vitin 2023.

Lindita Ballazhi thekson:- hera e parë ka qenë kërkesa për bartjen e të hyrave të pa shpenzuara duke i përfshirë gjithë këto vite 2020, 2021 dhe 2022 por në atë kohë kur kemi bërë kërkesën për bartje Qeveria nuk e lejonte bartjen e mjeteve nga viti 2020-2021 por vetëm nga viti 2022 dhe për këtë arsye është dashur me ndërruar kërkesën për bartje duke e përfshirë vetëm vitin 2022 që do të thotë që herën e dytë ka qenë kërkesa për bartje të mjeteve nga viti 2022 . Tash kemi pranuar vendimin prej Qeverisë që lejohen mjetet financiare të cilat janë të pa shpenzuara jo vetëm prej vitit 2022 por edhe nga vitet më të vjetra. Në material janë të specifikuar në detale.

Zaim Bela thekson:- a vetëm shuma e mjeteve financiare prej 1000 € ka mbetur prej viti 2020.

Lindita Ballazhi thekson:- të hyrat vetanake të bartura nga viti 2020 dhe 2021 në vitin 2022 kanë qenë në shumë prej 72,737.76 €, ku prej këtyre janë shpenzuar vetëm 62,485.72 €, ndërsa për bartje kanë mbetur edhe 10,252.04 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2022 kanë qenë në shumë prej 358,827.93 €, prej tyre janë të shpenzuara 243,822.54 €, kurse për bartje kanë mbetur 115,005.39 €. Pra në total, të hyrat vetanake të pashpenzuara të viteve 2020, 2021 dhe 2022 janë në shumën prej 125,257.43 €, të cilat i bartim në vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

U MIRATUA PLOTËSIM-NDRYSHIMI I VENDIMIT ME NUMËR 01/NR 5011/2023 PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA VITI 2020, 2021 DHE 2022 NË VITIN 2023

4. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2023 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:-a ka pasur fitim apo humbje për këtë periudhë të vitit 2023 , nëse ka pasur fitim apo humbje cila është shuma e fitimit apo humbjes . Të hyrat tjera prej Ministrisë së Punës është shuma prej 756.00 për çfarë arsye janë transferuar këto mjete te kompania “Pastrimi”. Shpenzimet e kompanisë në paga dhe mëditje pse shpenzimet e kontributit të punë marrësit , punë dhënësit dhe tatimit në burim janë më të mëdha në krahasim me gjashtë mujorin e vitit 2022 dhe në tabelë totali pagave në vitin 2023 është më i vogël se sa në vitin 2022 , kërkoj sqarim për këtë çështje. Te tatimet 8 % është paguar një shumë prej 2354.26 € , ndërsa për të njëjtën të viti 2022 shpenzimet janë zero zero , kërkoj sqarim. Te lista e punëtorëve shënon një punëtorë mirëmbajtës i programit Pro Data dhe shuma e kompensimit është 120 € kërkoj sqarim se për çfarë periudhe paguhet ky punëtorë dhe pse ka nevojë me bërë shpenzime për këtë nëse program është paguar nga kompania. Kërkoj informacion për tre punëtorët të cilët e kanë ndërprerë marrëdhënien e punës dhe janë punësuar në sektorë të tjera. Pse paga e arkatarës është e njëjtë me pagën e financierit dhe a është kjo punëtorë me kontratë të veçantë dhe a i është vazhduar kontrata.

Refet Kalisi thekson:- kemi biseduar për çështjen e ngritjes së pagave të punëtorëve në kompani por kemi bërë edhe ngritjen e tarifave a keni ndonjë informacion nga bordi se a ka ndërmarr diçka në këtë drejtim për shkak se punëtorët e kompanisë i kanë pagat e ulëta.

Mehmet Ballazhi thekson:- çështjen e pagave e kemi diskutuar por mundësit kanë qenë të mangëta për me u a ngritur pagat por kompania dhe kompania e ka bordin i cili vendosë për çështjen e ngritjes së pagave.

Sevime Bajrami thekson:- te totali i të hyrave dhe shpenzimeve shihet fitimi i kompanisë se sa është. Shuma prej 756.00 € ka të bëjë me punësimin e një punëtori të cilin 70 % e paguan Ministria e Punës ndërsa 30 % kompania.

Zaim Bela thekson:- a ka ndonjë familje e cila nuk ka kontratë dhe sa është numri i atyre që nuk janë të përfshirë në kompani.

Kryesuesi thekson:- janë duke e praktikuar përmes tiketave dhe shihet që është rritur numri i kontratave. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- në material i keni të gjitha temat të cilat i kemi diskutuar dhe aty ku kemi pasur mundësi me ndërmarr hapa janë ndërmarr por nuk është faktori i vetëm institucioni i Këshillit për Siguri në Bashkësi se pastaj involvohet prokuroria dhe instancat tjera por ne i trajtojmë si çështje dhe sipas procedurave përcillen më tutje dhe se çka ndërmarrin institucionet tjera është çështje tyre por si tema i kemi trajtuar të gjitha.

Sherif Berisha thekson:- është mirë me diskutuar çështjen e zhurmës pas orës njëzet e katër . Çështja e dukurive negative është mirë me i biseduar vazhdimisht. Kamerat janë vendosur dhe diskutohet në disa vende që janë hequr. Pasi që janë vendosur kamerat është një lehtësim për organet e rendit që me pas sa më shumë kujdes për dukuritë negative.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa i përket zhurmës ju e dini që është koha e mërgimtarëve që vijën dhe ndoshta krijohet një lloj tollovie dhe është problematike me u marr drektë me çështjen e zhurmës sepse nuk kemi aparate për me përcaktuar nivelin e zhurmës dhe kjo kohë mund të zgjatë deri në fund të gushtit dhe shyqyr që ka gjallëri. Për çështjen e kamerave ajo që ka qenë nën përgjegjësinë tonë, e kemi kryer dhe i kemi udhëhequr procedurat për vendosjen e kamerave dhe riparimin e tyre sipas kërkesës zyrtare të policisë që i ka përcaktuar pikat por mirëmbajtjen e tyre nuk e kemi sepse ju e dini që para se me ardhur kryetarë kamerat janë kontrolluar prej komunës por sipas ligjit i kam hequr për shkak se ka qenë shkelje ligjore dhe tash është në kompetencë të policisë. Për dukuritë e tjera të gjithë jemi të përkushtuar me i hequr dukuritë negative dhe nëse keni ndonjë informatë konkrete është mirë që ta njoftoni komunën, policës dhe organet përgjegjëse.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

6. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:-diçka të veçantë nuk kam përveç materialit të cilin e kam përcjell.

Zaim Bela thekson:- janë shënuar ndërhyrjet por nuk është cekur se ku ka pasur zjarre dhe nuk është cekur se a ka pasur dëme.

Sherif Berisha thekson:- a keni informacion për çështjen e rrugës Hani i Elezit- Gorancë se çka është tu ndodhur për shkak se ka rrezikshmëri nga shembja e dheut dhe gurëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- për këtë çështje është angazhuar nënkryetari i komunës por edhe në takimin e fundit që kam pasur me zëvendës ministrit e infrastrukturës ka potencuar që deri në fund të muajit qershor i kemi dhënë afat kompanisë që është dashur me i kryer punimet dhe tash është muaji korrik dhe nuk kemi ndonjë informacion .

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Resul Suma thekson:- dritat ka pjesa e poshtme e komunës janë ndërprerë. Ankesë kam pranuar prej banorëve të fshatit Dermjak dhe Dimcë për te fabrika e ujit në fshatin Dimcë është rrezik për shkak trafos dhe fabrika është e hapur , mund të hynë dikush dhe të ndodhë ndonjë incident, duhet të ja tërheqëni vërejtjen kompanisë “Bifurkacioni” për këtë çështje. Drejtoria ka pranuar një donacion te shkolla për disa deflibilatorë dhe janë shumë të mirë por a është organizuar ndonjë trajnim për përdorimin e tyre. Komiteti për komunitete e ka parë të arsyeshme së më herët kishte qenë e rregullume me rregullore që një barnatore deri në mëngjes me qenë hapur për shkak që QKMF punon njëzet e katër orë sepse ka raste që nëse nuk e qelë dikush një barnatore pacientët mbesin pa barna. Te parku “Isa Berisha” a kanë përfunduar punimet sepse shihet që sistemi i ujitjes nuk është mirë dhe shumica e parkut është djegë për shkak se ka pak ujë . Te parku te komuna sistemi i ujitje është rregulluar me qenë pikë pikë dhe e shohë një flutur që sillet aty dhe nuk e di a mundet me e ujitur komplet parkun. Problemi i cili ka ndodhur me bletarët është mirë me na i sqaruar këtë.

Arsim Dernjani thekson:- çështjen e mos funksionit të dritave do ta shikojmë se ku është problemi. Te çështja e ujit të Dimcës atë pjesë e kam rregulluar privatisht por e kanë dëmtuar përsëri por kam biseduar me përfaqësuesit e kompanisë “Bifurkacioni dhe kanë potencuar që e kanë një projekt për me rregulluar atë pjesë.

Hisni Luri thekson:- donacioni i deflibilatorëve është donacioni më i madh që KFOR-it Italianë që e ka dhuruar deri më tani dhe nuk na i kanë dhënë deflibilatorët pa e kryer edhe trajnimin por dy mësimdhënëse kanë qenë në shkollën për të cilën ka me u pajisur me deflibilator.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket parkut po thuaj se faza e dytë ka përfunduar dhe vetëm pranimi teknik ka mbetur dhe me çështjen e ujitjes kemi probleme por do të mundohemi me bërë zgjidhje. Te gypat e sistemit të ujitjes të parku te komuna sipas informacioneve që mi kanë dhënë janë zënë për shkak të ujit që vjen me baltë por problem ujitjen nuk e kemi.

Refet Kalisi thekson:-isha në QKMF për me i kryer disa analiza dhe potencuan që nuk bahen për shkak se nuk kemi material afër dy javë, a është furnizuar me material sektori i laboratorit.

Kimete Kuka -Hasallari thekson:-është e vërtet që nuk ka pasur material për shkak të përmbushjes së kontratës me operatorin ekonomik e cila ka përfunduar dhe procedurat e tenderimit marrin kohë deri sa të kryhen, janë rregulluar çështjet procedurale dhe laborator funksionon. Është rregullorja dhe do ta shikojmë këtë çështje.

Majlinda Kaloshi thekson:-gjatë muajit maj dhe qershor njëzetë gra kanë qenë të angazhuara me një trajnim për bletari nga organizata Women for Women dhe kanë pasur përfitim nga organizata me një shumë të caktuar për të cilën janë dakorduar pjesëmarrësit. Gjatë procedurave të tyre të prokurimit ka ndodhur një keqkuptim ndërmjet operatorit ekonomik dhe organizatës që kanë hasur në pakënaqësi dhe ju kanë drejtuar komunës me ankesë për këtë çështje dhe drejtoria ka kontaktuar me organizatë dhe kemi hasur në mirëkuptim dhe pas tri dite janë zëvendësuar pajisjet e tjera të cilat kanë qenë në mungesë. Për këtë rast komuna ka qenë vetëm një urë lidhëse ndërmjet organizatës dhe komunitetit.

Zaim Bela thekson:- a janë mundësit që në vjeshtën e ardhshme me u subvencionuar fermerët të cilët mbjellin grurë apo me plehra artificiale.

Abduraman Bushi thekson:- vitin e kaluar kanë qenë dymbëdhjetë hektarë ndërsa në këtë vit tridhjetë e katër. Sa i përket subvencionimit kemi me i subvencionuar pjesërisht mbjelljet në vjeshtë dhe fillimisht do të shikohen se sa do të ketë kërkesë dhe brenda mundësive buxhetore që i kemi do t'i subvencionojmë .

Sherif Berisha thekson:-është mirë me i njoftuar bujqit me kohë për shkak se vjeshta vjen shumë shpejtë

Xhevahir Dernjani thekson:-është mirë që nuk kemi pasur zjarre deri më tani. Është mirë që me bërë zgjidhje drejtorja e urbanizmit te parku për shkak se 300 deri në 400 persona po dalin në mbremje dhe nga kjo foltore kam potencuar që atë park ne ta shfrytëzojnë qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit dhe komuna duhet ta mirëmban.

Sherif Berisha thekson:- kërkoj nga drejtorja për urbanizëm se deri ku kanë mbërri procedurat për inspektor të ndërtimit. Kryetari i komunës ka pasur një takim me pronarët e shitoreve të cilët janë te kufiri është mirë të na njofton.

Nexhmedin Daci thekson:-çështja e inspektorit është në kuadër të drejtorisë për shërbime publike sepse është konflikt interesi me qenë në kuadër të drejtorisë për urbanizëm dhe kemi kërkuar me kontratë mbi vepër dhe nuk është paraqitur askush.

Mehmet Ballazhi thekson:- javën e kaluar kam pasur takim me pronarët dhe i kemi njoftuar për projektin që do të zhvillohet në atë pjesë dhe për largimin e atyre aseteve duke filluar nga data një shtatorë deri me datën një tetor është afati i largimit. I kemi ofruar mundësin për bashkëpunim nëse dikush nuk i ka mundësit. Që duhet me u larguar janë të njoftuar në takimin që e kemi pasur në sall të Kuvendit të Komunës.

Hanumshahe Dibrani thekson:- kërkoj nga drejtorja për shërbime publike një sqarim për çështjen e ujit. Kërkoj që të vendosen shporta për mbeturina te Lagjja e Re.


Arsim Dernjani thekson:-informacion nga kompania Bifurkacioni nuk kam më shumë për çështje të ujit përveç se më ka njoftuar se që nga dita e nesërme do të fillojnë punën katër punëtorët që janë pranuar. Për çështje të shportave për mbeturina kemi planifikuar edhe për qytet edhe nëpër fshatra.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:44.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta





RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
2023

TAKIME:

- Takim të përbashkët me Drejtorin e Zyrës së Punësimit në Ferizaj, Drejtorin e Burimeve Njerëzore të SharrCem, Udhëheqësin e ZP-së në Han të Elezit.
- Takim me përfaqësues nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
- Forumi rajonal "Institucionet lokale dhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm (PVE) dhe resocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi (RRR): praktikat rajonale, përgjegjësitë e përcaktuara dhe procedurat".
- Pjesëmarrës në Bashkinë e Lezhës në Besëlidhja e Lezhës e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.
- Takim me Drejtorin për Kosovë të Caritasit Zvicerian
- Vizitë në Prekaz për nder të Epopesë së UÇK-së, në familjen e Rifat Jasharit.
- Takim me Humanity First Kosova.
- Takim me Institutin e Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup
- Takim me zv.Ministrin e Infrastrukturës.
- Takim me KFOR-i Italian.
- Takim me Drejtorin e ri të Organizatës së Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë (OSBE),
- Takim me Agjencinë Kadastrale e Kosovës,
- Takim me Kryetarin e Komunës së Celanos-Itali.
- Takim me zv.Ministrin e MAPL-së.

*Nuk janë të përfshirë të gjitha takimet mirëpo më të rëndësishshmet, ndërsa vlen të theksohet se **Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, pret çdo ditë qytetarë të cilët duan të diskutojnë me të për çështje të ndryshme.***

MARRËVESHJE:

1. Marrëveshje me MMPHI për Projektin "Rregullimi i hapësirave publike dhe zgjerimi i rrugëve afër zonës kufitare".
2. Memorandum Mirëkuptimi me organizatën Humanity First Kosova për familje në nevojë me pako me produkte ushqimore për festën e Kurban Bajramit.
3. Marrëveshje në kuadër të projektit TAKE në Fushën e Arsimit.
4. Marrëveshje e Bashkëpunimit mes Komunës së Hanit të Elezit dhe Organizatës Qatar Charity – Kosova për pako ushqimore gjatë muajit Ramazan dhe Kurban Bajramit.
5. Bashkëpunim me kompaninë IPKO për vendosjen e sistemit të sofistikuar të ultrazërit.

PROJEKTET E HARTUARA:

1. Rregullimi i hapësirave publike dhe zgjerimi i rrugëve afër zonës kufitare Hani i Elezit.
2. Rregullimi i parkut afër Lumit Lepenc.
3. Projektin për vendosjen e paneleve solare në objektin e QKMF-së.
4. Hartimi i fazës finale të projektit i Parkut të Qytetit "Isa Berisha".
5. Hartimi i projektit të mbikalimit tek Cerdhja Ardhmëria.
6. Hartimi i fazës finale të projektit tek AMF në Fshatin Gorancë.
7. Hartimi i projektit për shtegun të çiklistëve në magjistralen Hani i Elezit – Kaçanik.
8. Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të Lumit Lepenc.
9. Hartimi i projektit për ndertimin e mureve mbrojtës në Lagjen e re dhe në fshatrat Paldenice, Pustënik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë

10. Hartimi i projektit për ndërtimin e shkallëve emergjente në SHFMU “Kështjella e Diturisë” - Paldenicë dhe SHFMU “Veli Ballazhi” – Gorancë.
11. Hartimi i projektit “Ndriçimi publik në zonën urbane dhe rurale në Han të Elezit në rrugën e Të Përndjekurve”.
12. Mbikalimi në afërsi të çerdhes së qytetit, vlera e projektit është në shumë prej 1,147,004.00 €.

SUBVENCIONE:

- Është rritur për 10 numri i studentëve bursistë, ku për vitin 2023 kanë përfituar 40 studentë/e, për herë të parë janë përfshirë edhe studentët që studiojnë në universitetet publike të shteteve fqinje, gjithsej në vlerë 20 mijë €.
- Janë stimuluar organizatat joqeveritare, me ç'rast kanë përfituar numër rekord i organizatave (8 OJQ), duke përfshirë ata të fushës sportive, kulturore, rinore dhe të tjera (Handikos), në vlerë totale prej 26 mijë €.
- Subvencione të tjera për përfitues individualë, duke përfshirë lehonitë dhe rastet e ndihmesës shëndetësore, që tejkalojnë shumën 10 mijë €

PROJEKTE DHE INICIATIVA PËR HERËN E PARË:

- FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTAR HANI I ELEZIT 2023 - I realizuar nën patronatin e Kryetarit të Komunës, dhe i cili synon të bëhet tradicional në datat 9, 10 dhe 11 Qershor.
- PËRKRAHJE PËR VENDOSJEN E SHKRONJAVE TË UÇK-SË.
- PJESËMARRJE NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË TURIZMIT DHE SPORTIT.
- THEMELIMIN E EKIPIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS.

ZYRA LIGJORE

Zyra ligjore është e radhitur në organogramin e komunës në zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila gjatë gjashtëmujorit të vitit 2023 ka vazhduar punët dhe detyrat në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe udhëzimeve të tjera nga ana e eprorit, përkatësisht nga Kryetari i Komunës dhe gjithashtu bashkëpunimin me drejtorët e drejtorive dhe me zyrtarë të tjerë. Si zyrë, kemi bashkëpunuar me të gjithë sektorët e komunës dhe kemi arritur që pajtueshmëria e akteve të komunës të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Shkurtimisht do të paraqesim numrin e akteve juridike të përpiluara gjatë gjysëm vitit të parë të 2023. Në këtë zyrë gjatë periudhës së raportimit, janë përpiluar akte juridike të cilat do t'i shënojmë në tabelën e mëposhtme dhe do t'i krahasojmë me gjysëmvitin e kaluar:

Viti	Vendime	Përgjigje ne kërkesa	Përgjigje ne padi	Autorizime	Njoftime	Vërtetime	Rekomandime	Kërkesat në inst. qendrore	Kontratë mbi shërbimin	Përgjigje ne kërkesë auditorve
2022	92	12	65	20	3	2	3	3	0	1
2023	80	8	10	5	4	-	2	4	0	-
Dif.	-12	-4	-55	-15	+1		-1	+1	0	

Duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e zyrës ligjore të gjitha aktet juridike të lartshënuara kanë qenë të hartuara dhe të mbështetura në dispozitat e aplikueshme të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë gjysëm vitit 2022 ka miratuar vendime, akte juridike brenda fushës së kompetencës së tij të cilat do t'i paraqesim sipas muajve vijues dhe do t'a bëjmë krahasim me gjysmë vitin 2023, duke i specifikuar vendimet dhe rregulloret.

Muaji	Janar		Shkurt		Mars		Prill		Maj		Qershor		Korrik		Gusht		Shtator		Tetor		Nëntor		Dhjetor	
Viti	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023		2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
Vendime	4	6	6	3	2	6	3	5		6	6	7												
Rregullore							1	1			1													

Nga kjo tabelë rezulton se gjatë gjysmë vitit 2022 gjashtëmujori i parë nga kuvendi i komunës së Hanit të Elezit janë miratuar gjithsej: 21 vendime, ndërsa në gjysëm vitin 2023 të gjashtëmujorit të parë janë miratuar 33 vendime dhe një Rregullore, pra janë miratuar 12 vendime më shumë se në vitin 2022.

Sa i përket vendimeve të miratuara zyra ligjore prej muajit Janar të vitit 2022 deri në muajin që po raportojmë në afatin e paraparë ligjor ka përcjellur të gjitha vendimet dhe rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit me shkresë përcjellëse në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për shqyrtim të ligjshmërisë), të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, vendimet janë cilësuar me efekt të plotë juridik dhe nuk kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin, (këtu duhet të ceket se MAPL nuk ka përcjellë konfirmimet për të gjitha aktet tona të miratuara, por vetëm për disa që kanë qenë në kompetencë të tyre).

Zyra ligjore përveç çështjeve juridike të sipërpërmendura merret edhe me përfaqësime juridike në Gjykata.

Gjatë periudhës së raportimit në komunën e Hanit të Elezit ka pasur padi të ndryshme, por më shumë kemi padi për vërtetim të pronësisë, si zyre ju kemi bërë përgjigje në padi dhe kemi përfaqësuar komunën në Gjykata. Gjithashtu pas marrjes së aktgjykimeve në shkallën e parë të gjykatës kemi bërë ankesa në gjykatën e shkallës së dytë. Gjatë kësaj periudhe kemi mbajtur 35 seanca Gjyqësore në Gjykatë Themelore në Ferizaj, dega Kaçanik dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Për të gjitha llojet e padive duke respektuar Ligjin për procedurën kontestimore kemi bërë prapësime procedurale me përgjigje në padi në afatin ligjor, përfaqësimin e tyre me autorizim nga ana e Kryetarit të Komunës sipas ftesave të Gjykatës.

Vlen të theksohet se për shkak të mos zbatimeve të vendimeve administrative, pas plotfuqishmërisë së tyre debitorëve kemi bërë propozim për përmbarimin e vendimeve përmes përmbaruesit privat.

Zyra ligjore ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal dhe atë të Administratës Publike, në fushën e ligjshmërisë të akteve Ligjore dhe nënligjore.

Kjo zyrë ka bërë pajtueshmërinë e akteve ligjore në Komunë nëpër sektorë dhe kemi dhënë disa komentime lidhur me dispozitat e Ligjeve, Rregulloreve apo Udhëzimeve Administrative.

Kemi pasur dy punëtori me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me OSBE, ku unë jam edhe kryesues i Kolegjiut të Zyreve Ligjore janë trajtuar projekt ligje, udhëzime administrative dhe rregullore të ndryshme.

Zyra Ligjore
Bajrush Laçi

ZYRA E PERSONELIT

Në zyrën e personelit gjatë periudhës janar-qershor 2023 janë kryer disa aktivitete, duke filluar, mirëmbajta e dosjeve, kërkesat dhe shkresat përcjellëse Ministrisë së Administratës Publike dhe institucioneve tjera, bashkëpunimi me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik , njoftimin e punëtorëve rreth pushimeve dhe festave zyrtare, ndjekjen e trajnimeve, zbatimin e Ligjit për zyrtarët Publik.

Ndër aktivitetet më të rëndësishme të zyrës së personelit për këtë periudhë kanë qenë:

- Përgaditja e tabelës së klasifikimit të pozitave, vendosja e pozitave dhe klasës sipas Ligjit për pagat dhe rregullores për klasifikimin e vendeve të punës (e njëjta është përcjellur në DMZP)
- Në DMZP janë përcjell gjitha aktemërimet, kontratat dhe vendimet e punës për të gjithë të punësuarit si në sektorin e administratës, arsimit dhe shëndetësisë
- Çdo muaj janë nxjerrë listat e pagave nga sistemi i pagave të cilat janë përcjellë tek drejtoritë përkaktëse për nënshkrim gjithashtu në thesar janë përcjell ndryshimet në paga për të gjithë nëpunësit.

Janë përgaditur:

- 15 vendime për mëditje jashtë vendit
- 6 vërtetime për mardhënien e punës
- 3 vendime për përvojë të punës
- 1 vendim për zbatimin e vendimit të Këshillit të Pavaru Mbikqyrës për Shërbimin civil
- 4 përgjigje në kërkesa
- 2 shkresa përcjellëse për komisionin e ankesave
- 1 vendim që nëpunësi nuk ka ndonjë masë disiplinore
- Plani i trajnimeve për vitin 2023
- Plani i punës për vitin 2023
- Raporti i aktiviteteve të ndërmarra në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik

Nga zyra e personelit janë udhëhequr gjithsej **20** procedura të rekrutimit , duke përfshirë shpalljen e pozitave, verifikimin paraprak, formimi i komisioneve të pranimit, organizmi i testeve dhe intervistave, shpallja e rezultateve përfundimtare.

Në sektorin e arsimit janë zhvilluar gjithsej **14** procedura të rekrutimit prej të cilave **8** janë të përfunduara ndërsa **6** janë në proces.

Të përfunduara janë :

- 1.Punëtor Teknik-1 pozitë “IP Ardhmëria”, 2 pozita shfmu “Ilaz Thaqi”, 1 pozitë shfmu”Veli Ballazhi”
- 2.Ndihmës Kuzhiner-“IP Ardhmëria”
- 3.Matematikë-rishpallje shfmu “Veli Ballazhi”
- 4.Edukatore Mbeshtetes-shfmu “Ilaz Thaqi”
- 5.Matematikë-shml “Dardania”
- 6.Arsim fillor-shfmu “Kështjella e Diturisë”(zëvendësim)

7. Arsim Fillor-shfmu “Kështjella e Diturisë”

8. Edukatore Mbeshtetes-rishpallje shfmu “Ilaz Thaqi”

Duke u zhvilluar janë:

1. Arsim Fillor-shfmu “Veli Ballazhi” zëvendësim
2. Gjuhë Shqipe-shml “Dardania”
3. Art Figurativ-shml “Dardania”
4. Gjuhë Shqipe-shfmu “Ilaz Thaqi”
5. Arsim Fillor- shfmu “Ilaz Thaqi” zëvendësim
6. Gjuhë gjermane-shfmu “Ilaz Thaqi”

Në sektorin e shëndetësisë janë zhvilluar 3 procedura të rekrutimit prej të cilave 1 është përfunduar me sukses për pozitën Mjek të mjekësisë familjare ndërsa 2 konkurse për pozitën Drejtor i QKMF-së janë anuluar për shkak të mungesës së kandidatëve që plotësojnë kriteret.

Në sektorin e administratës janë zhvilluar 3 procedura të rekrutimit dhe atë:

1. “Zyrtar për tatimin në pronë”
2. “Zyrtar i burimeve njerëzore”
3. “Zyrtar për hapësira publike”

Zyra e Personelit
Ajete Berisha-Duraj

Nr	Pershkrimi	Hapja	Data e nenshkrimit	Vlera e planifikuar	Kontrata e nenshkruar	Pune shtese	Operatori ekonomik fitues
----	------------	-------	--------------------	---------------------	-----------------------	-------------	---------------------------

ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit zhvillon aktivitetet e prokurimit, konform dispozitave ligjore të Ligjit të prokurimit Publik 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-237 Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092, Rregulloren për Prokurimi Publik nr.01/2022, Udhëzuesin për Prokurim Publik 01/2023 dhe Interpretimet ligjore të lëshuara nga Organet kompetente.

Zyra e prokurimit gjatë këtij muaji ka zhvilluar aktivitete të tenderimit dhe kemi përgatitur lëndë dhe pagesa duke i dërguar ne zyrën për financa. Me ligjin në fuqi për çdo procedurë i drejtohem KRPP-së.

Kemi zhvilluar këto lloje të procedurave :

1. Procedura me vlera minimale mbi 100.00 € dhe më pak se 1,000.00 €
2. Procedura me vlera të vogla (Kuotim i çmimeve) vlerat nën 10,000.00 €uro dhe
3. Procedura me vlera të mesme mbi 10,000.00 €.

Procedura me vlera të vogla dhe të mesme vlerat mbi 1,000.00 dhe me pak se 100,000.00; € (furnizime & shërbime & punë)

Gjatë vitit kemi pasur kontakte dhe koordinim të vazhdueshëm me organet kompetente të prokurimit publik si KRPP për interpretimet dhe rregulloret në fuqi, koordinimin me AQP-në lidhur me planin e prokurimit dhe procedurat e paplanifikuara në buxhetin e Komunës dhe me OSHP-në për ndonjë ankese, ku ne si Zyre e Prokurimit nuk kemi pasur raste të ankesasve .

Të bashkangjitur gjeni raportin e krijuar nga Platforma elektronike e prokurimit për të gjitha procedurat e zhvilluara si vlera të vogla, të mesme dhe të mëdha sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

1	"Furnizim me flamuj dhe bishata për flamuj	7.2.2023.	14.2.2023.	700,00	605,00		" 1 EURO STORE " SH.P.K.
2	Instalimi i filtrave te nxemjes ne Qendren Kryesore te Mjekësisë Familjare - KKHE(VM) 23-003-147	14.2.2023	28.2.2023.	450,00	450,00		" Termovision " SH.P.K.
3	Furnizimin me material për mirëmbajtje të automjeteve komunale KKHE(VM) 23-002-147	7.2.2023.	21.2.2023.	988,00	983,00		Basri Dernjani B.I.
4	Sherbime konsulente- Angazhimi i nje (1) konsuleti-e te gjuhes angleze per nevoja te Drejtorisë se Arsimit.	26.1.2023.	22.2.2023.	2.700,00	2.700,00		Lirinda Dernjani
5	Furnizimi dhe riparimi instalimeve elektrike ne Qendren Kryesore të Mjekësis Familjare Dr."M.Kaloshi" KKHE 23-004-147	21.2.2023.	28.2.2023.	998,00	998,00		ELEKTRA L.L.C.
6	Furnizim me nje telefon mobil per nevoja te aktiviteve komunale dhe incizim te seancave te Kuvendit Komunal	27.1.2023.	28.2.2023.	999,50	999,50		Sevxhane Vila B.I.
7	Mirembajtja e ndriçimit publik ne zonen urbane dhe rurale-	26.1.2023.	28.2.2023.	9.999,00	9.940,00		TERMOMONTIMI
8	Zhblllokimi i gypave te kanalizimit fekal dhe atmosferik ne zonen urbane dhe zona rurale te Komunes së Hanit të Elezit	2.2.2023.	1.3.2023.	9.998,00	9.994,00		"EUROPLUS" SH.P.K
9	Shërbime konsulete -Angazhimi i një (1) psikolog-e per nevoja te QPS-së KKHE-23-007.236	6.2.2023.	3.3.2023.	1.680,00	1.680,00		Menduhije Curri
10	Mirëmbajtja e shportave te mbeturinave, ulëseve të parqeve,ngjyrosjen,rrethojat e hekurta,shenjave te dëmtuara,salldimin e mbrojtseve.KKHE-23-006-236	31.1.2023.	9.3.2023.	2.000,00	1.970,00		Zija Shkreta B.I.
11	Furnizim dhe montim me material sanitar dhe elektrikë ne objekin e QKMF-së KKHE-23-008-136	10.2.2023.	9.3.2023.	2.010,00	1.396,60		GLOBAL ING SH.P.K.
12	Incizime dhe fotografime per nevoja te aktiviteve te ndryshme kulturore dhe historike KKHE(VM) 23-006-247	1.3.2023.	15.3.2023.	990,00	990,00		Muhamet Dernjani B.I
13	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	17.3.2022.	27.4.2023.	11.350,00	10.397,00		ARITECH
14	Furnizimi, renovimi, zgjerimi dhe pajisja me tabela informuese ne hyrjen kryesore te objektit te komunes, Qendres per sherbim te qytetareve brenda komunes KKHE-23-011-136	9.2.2023.	16.3.2023.	6.908,00	4.600,82		" KROSA traffic signs " SH.P.K.
15	Shërbime saldimi, sanimi dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në institucionin parashkollorë "Ardhmëria" KKHE-23-007-247	8.3.2023.	17.3.2023.	750,00	748,00		Zija Shkreta B.I.
16	Ndertimi i trotuarit per kembesor te ura e Seçishtes (Ndertimi i aneksit te ures per kembesor dhe rregullimi i parkut)	3.2.2023.	23.3.2023.	9.960,50	6.899,75		MODELI INVEST GROUP SH.P.K.
17	"Furnizim me material stomatologjik për nevoja të QKMF-së"-KKHE-23-009-147	15.3.2023.	27.3.2023.	997,00	997,00		PRO MEDICAL SH.P.K.
18	"Furnizime shtypi dhe fotografime për nevoja	17.3.2023.	28.3.2023.	980,00	980,00		Muhamet Dernjani

	te SHFMU.“Ilaz Thaçi” & SHFMU.”V.Ballazhi” KKHE(VM) 23-010-147						
19	Ndërtimi i ankesit për këmbësor ne urën e Seçishtës	3.2.2023.	29.3.2023.	42.040,89	32.910,05		Company Murseli SH.P.K.
20	Furnizime dhe montim i elementeve te kanalizimit dhe ujësjesit ne toaletet e administrates komunale KKHE(VM) 23-011-147	28.3.2023.	31.3.2023.	951,09	951,00		"ELEKTRO XAMI" SH.P.K.
21	Furnizim me material hixhenik per nevoja te institucionin parashkollorë “Ardhmëria” KKHE-23-008-147	14.3.2023.	4.4.2023.	759,00	759,00		LANTI PLAST SH.P.K.
22	“Furnizim nme disa paisje per nevoja te administrates komunale KKHE-VM 23-012-147”	8.3.2023.	13.4.2023.	995,00	995,00		Naim Axhami B.I.
23	Hartimi i projektit te depos tek QKMF, rregullimi i parkingut dhe ermbrojtësit tek emergjenca	6.4.2023.	14.4.2023.	980,00	970,00		" URBAN PRO " SH.P.K.
24	Angazhimi i nj mjeku-e për nevoja të QKMF-së” KKHE(VM) 23-014-247	12.4.2023.	14.4.2023.	600,00	600,00		Fatbardha Sadriu
25	Furnizim me material higjienik per nevoja te Institucioneve	10.3.2023.	19.4.2023.	9.995,00	8.851,95		PM GROUP SH.P.K.
26	Furnizim dhe montim i kamerave ne qytet dhe ne objektin e administratës komunale KKHE-23-009-136	6.2.2023.	25.4.2023.	7.360,00	4.846,50		" INFINITT " SH.P.K.
27	Furnizim me lule per nevoja te Komunes Hani i Elezit KKHE-023-015-136	28.2.2023.	27.4.2023.	1.742,50	1.999,80		LULISHTJA ASIMI SH.P.K.
28	Hartimi i raportit te vleresimit strategjik mjedisor te PZHK-se	21.2.2023.	27.4.2023.	5.950,00	3.273,00		N.SH. " GEO - MININGU "
29	Sherbime profesionale shendetesore per nevoja specifike ne QKMF- Hani i Elezit	16.3.2023.	4.5.2023.	30.000,00	29.650,00		C.I.K
30	Furnizim me material per mirembajtje (vegla pune) per nevoja te komunes, shkollave, QKMF-se, Cerdhes etj	24.3.2023.	5.5.2023.	16.971,65	15.921,45		Naim Axhami B.I.
31	Montimi i filterit dhe valvola për reduktim të shtypjes së ujit tek Qendra Kulturore si dhe furnizimi dhe lidhja e kablos tek gjeneratori i çerdhes” KKHE(VM) 23-017-147	4.5.2023.	12.5.2023.	994,00	990,00		B&S Gardenbau SH.P.K.
32	Ndriqimi publik ne zonen urbane dhe rurale ne Han te Elezit, KKHE-23-014-5-2-1	14.2.2023.	12.5.2023.	14.999,00	14.869,75		ELEKTRA L.L.C.
33	Servisimi dhe mirembajtja e autoambulances Llot.1 - Renault Trafic	3.2.2023.	16.5.2023.	2.007,00	1.279,40		D.P.Z."Golf"
34	Servisimi i autoambulances - Llot 2 VË T5	3.2.2023.	16.5.2023.	2.087,00	1.341,40		D.P.Z."Golf"
35	Servisimi i autoambulances - Llot.3 Peugeot Boxer 2.0 HD	3.2.2023.	16.5.2023.	2.057,00	1.430,60		D.P.Z."Golf"
36	Riparimin e rrjetit elektrik ne objektin e Administrates Komunale” KKHE(VM) 23-018-147	10.5.2023.	18.5.2023.	930,65	930,65		"ELEKTRO XAMI" SH.P.K.
37	Furnizim me material shtypi per nevoja të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ”- KKHE(VM) 23-015-1-4-7”	25.4.2023.	18.5.2023.	999,00	998,00		PRO MIX SH.P.K.

38	Furnizim me kubëza, humus dhe reshetka atmosferike” KKHE-VM 23-016-1-4-7”	12.5.2023.	19.5.2023.	919,00	915,00		MODELI INVEST GROUP SH.P.K.
39	Servisimin e aparatit të RTG në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare” Dr Menduh Kaloshi” Hani i Elezit	11.5.2023.	22.5.2023.	950,00	950,00		LEDI MED SH.P.K.
40	Shtimi i kapaciteteve të ujërave të pijshme - KKHE-23-025-5-2-1	27.3.2023.	25.5.2023.	39.999,25	29.449,20		Grup i Operatorëve Ekonomik FIN COMPANY SH.P.K.; N.N. 100 % Design Sh.p.k.
41	Rregullimi i parkut në rrugën Isa Berisha (asfaltim, trotuar, ndricim publik, gjelberim) - faza e dytë	21.3.2023.	29.5.2023.	20.000,00	19.999,99		Company Murseli SH.P.K.
42	Furnizim me material të IT-së për nevojat e Administratës Komunalet KKHE-23-027-1-3-6	18.4.2023.	1.6.2023.	4.117,00	2.977,30		EUROPRINT GROUP SH.P.K.
43	Furnizim me dyshe me presur për sallën e Edukimit Fizik për SHFMU. Ilaz Thaçi - Hani i Elezit	23.5.2023.	6.6.2023.	986,00	986,00		N.P.T. " DAQA "
44	Furnizim me material administrativ dhe shtyp jashtë listës së AQP-së për nevojat e Institucioneve (komunës, shkollave, QKMF-së, Çerdhës)	10.2.2023.	6.6.2023.	20.639,00	19.054,76		PRO MIX SH.P.K.
45	Furnizim me ram plastikë dhe brava të dyerve të SHFMU.” Ilaz Thaçi” KKHE(VM) 23-022-147	18.5.2023.	6.6.2023.	895,00	895,00		KRAS MK SH.P.K.
46	Furnizime shtypi dhe material tjetër për nevojat e Festivalit Mbarkombtar Folklorik KKHE-VM-23-024-147	2.6.2023.	9.6.2023.	950,00	950,00		PRO MIX SH.P.K.
47	Incizime të ndryshme për nevojat e Festivalit Mbarkombtar Folklorik KKHE-VM-23-025-247”	2.6.2023.	9.6.2023.	980,00	980,00		Muhamet Dernjani
48	Sherbime të DDD-së për nevojat e QKMF-së, komunës, shkollave dhe xhamive të Komunës Hani i Elezit	2.5.2023.	15.6.2023.	8.580,00	3.270,00		Besim A. Zejnullahu B.I.
49	Furnizim me uniformë pune për puntorët teknik të SHFMU.” Ilaz Thaçi” KKHE(VM) 23-027-147	8.6.2023.	19.6.2023.	900,00	900,00		Igballe Thaqi Bushi B.I.
50	Furnizim me kose bari dhe trimër	10.5.2023.	20.6.2023.	2.990,00	2.880,00		N.P.T. " Bajra "
51	Sherbime të zërimit për nevojat e Festivalit Mbarkombtar Folklorik KKHE-VM-23-026-247	7.6.2023.	19.6.2023.	999,00	996,00		Adnan Zuka B.I.
52	Furnizimi dhe montimi i pasqyrave rrugore O 60 me pajisje përcjellëse KKHE (VM) - 23-028-1-4-7	14.6.2023.	20.6.2023.	994,50	988,00		" KROSA traffic signs " SH.P.K.
53	Furnizim me material sportivë për Ditën e Kulturës për vitin 2023” KKHE(VM) 23-020-147	15.5.2023.	13.6.2023.	996,00	996,00		VLERASPORT LTD SH.P.K.
54	Zhvendosja e shtyllës së rrymës me pajisje tjera përcjellëse të SHFMU.” Ilaz Thaçi” KKHE(VM) 23-029-247	6.6.2023.	3.7.2023.	978,30	978,30		ELEKTRA L.L.C.
55	Furnizim me inventar për zyrë	9.6.2023.	4.7.2023.	5.270,00	4.650,00		"Mobelland" SH.P.K.

56	Hartimi i projektit - Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike ne zonen urbane rr.Adem Jashari dhe fshatin Paldenice	3.5.2023.	30.6.2023.	2.005,00	979,00		DEA GROUP SH.P.K.
----	--	-----------	------------	----------	--------	--	-------------------

Zyra e prokurimit sipas procedurave të Ligjit mbi Prokurimin Publik 04/L-042.

Procedura mbi 1,000.00 €

Procedura nën 1,000.00 €

Zyra e Prokurimit
Xhevdet Bushi
Avdush Bajramaliu

ZYRA PËR INFORMIM

Raporti gjashtë mujor i punës së zyrës së arkivit dhe transparencës për vitin 2023

Numri i publikimeve në ëeb-Faqen Zyrtare 01.01.2023-30.06.2023

Viti	Gjithsej	Dokumente	Lajme
2022	337	248	89
2023	531	413	118

Numri i kërkesave për Qasje në Dokumete Publike 01.01.2023-30.06.2023

Viti	Kërkesa	Me përgjigjeje	Pa përgjigjeje
2022	09	09	00
2023	03	03	00

Numri i Lëndëve të Procesuara përmes SMAED-it . Nga datë 02.05.2023 sistemi është jashtë funksionit andaj nuk mund të gjeneroj të dhënat e procesuara sipas kërkesës suaj.

Zyrtari për Informim
Bashkim Sopa

ZYRA PËR BARAZI GJINORE

1.Takimi mujor i KKSBB-së i mbajtur me dt.30.03.2023 nga ora 14:00 mbi raportimin e problemeve dhe gjendjes te komunës së Hanit të Elezit.

2.”8 Marsi Dita e Gruas” më dt. 08.03.2023 për nderë të festës së Gruas Zyra për Barazi Gjimore në kuadër të kësaj feste u organizua një takim me drejtoreshat, zyrtaret komunale dhe përfaqësuese nga asambleja komunale, ku u shpreh mirënjohje për punën e tyre dhe angazhimit të tyre në marrjen e hapave për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri.

3.Takimi dy mujor për Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit i mbajtur më dt.31.05.2023 ora 14:0000 mbi raportimin e problemeve dhe gjendjes te komunës së Hanit të Elezit.

4.Përgaditja e planit të punës mbi formimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, për komunën e Hanit të Elezit për vitin 2023-2025.

5. Draftimi i Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje për Mekanizmin Koordinues Komunal kundër Dhunës në Familje në Han të Elezit.

6.Takim informues për bashkupunim me Instituti e Prishtinës për Studime Politike (PIPS) *ku ky është një program gjashtëmujor për informimin e të drejtave të njeriut qe synon të sjellë informacione thelbësore, dhe mbështetje të komuniteteve joshumicë në Kosovë. Ku komuna do te bashkepunoj për sesione informues per komunitetin tone.*

Zyrtare për Barazi Gjimore
Vjosa Livoreka

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Drejtorja e Administratës së Përgjithshme gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 ka qenë e përkushtuar për miratimin dhe funksionimin e rregullt të sistemit Intranet, ku procesohen kërkesat/ankesat dhe shërbime të tjera me qytetarët.

- Kemi pasur efikasitet në shërbimet e gjendjes civile me kërkesat e qytetarëve, ku deri me 15 janar 2023, kanë vazhduar të jepen dokumente të gjendjes civile gjatë pauzës dhe fundjavës për shkak të fluksit të madh të punës, gjatë kohës së qëndrimit të bashkëatdhetarëve tanë.
- Është realizuar projekti i infografikave për orientim në komunë, si dhe digjitalizimin e njoftimeve.
- Rifunksionalizim I kamerave të sigurisë së qytetit dhe zonave përreth në Komunën e Hanit të Elezit.
- Janë mbajtur punëtoritë për “Kompetencat e Komiteteve Konsultative dhe Këshillave Lokal në Komunën e Hanit të Elezit”, “Plani i veprimit për transparencë 2023-2026”, “Gjinia, Paqja dhe Siguria”.
- Pjesëmarrje nëpër trajnime, seminare e konferenca, të cilat prekin drejtpërdrejt interesin e Administratës së Përgjithshme për sjelljen e aktiviteteve të reja.
- Janë inicuar 14 procedura të prokurimit në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.
- Funksionalizimi i linjës telefonike pa pagesë për qytetarët për ankesat/kërkesat dhe pyetjet e ndryshme që mund të zhvillohen.
- Në kuadër të Drejtorisë, gjeni të paraqitura më poshtë sektorët dhe punët e tyre.

1. Qendra për Shërbim me Qytetarë

Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
Kuvendi Komunal	0	0	71	0	0	0	0	0	0	71
Kryetari i Komunës	0	113	317	33	0	0	0	0	0	463
Drejtorja e Administratës së Përgjithshme	0	16	351	0	2	0	0	3	2,458	2,830
Drejtorja për Buxhet dhe Financa	0	1	391	4	1	0	0	0	0	397
Drejtorja për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	0	0	175	0	2	0	0	0	0	177
Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	0	21	1,081	0	9	0	0	2	0	1,113
Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0	1	26	0	0	0	0	0	0	27
Drejtorja e Politikave Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik	0	0	42	0	1	0	0	0	0	43
Zyra e Prokurimit	0	2	59	0	0	0	0	0	0	61
Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	0	2	39	0	0	0	0	0	0	41
Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	1	64	0	0	0	0	0	0	65
	0	157	2,616	37	15	0	0	5	2,458	5,288

Krahasime:

Në vitin 2023 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 5,288 lëndë

+526 lëndë 

Në vitin 2022 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 4,762 lëndë

+111 lëndë 

Në vitin 2021 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 4,651 lëndë

2. Gjendja Civile

Pershkrimi	Miraturar	Refuzuar	Totali
Vërtetim nga arkiva	33	0	33
Certifikata e Martesës	348	0	348
Certifikata e statusit martesor	92	0	92
Certifikata e vendbanimit	274	0	274
Certifikata e Shtetësisë	24	0	24
Certifikata e lindjes	464	0	464
Certifikata e vdekjes	73	0	73
Deklarate e bashkësisë familjare	493	0	493
Ekstrakti i lindjes	1,568	0	1,568
	3,369	0	3,369

Krahasime:

Në vitin 2023 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 3,369 shërbime.

 +1,116 dokumente

Në vitin 2022 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 2,253 shërbime.

Në vitin 2021 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë 2,571 shërbime.

Lëndët e Liruara nga Pagesa → 544lëndë.

3. Sektori i Kuvendit

- ☐ Kuvendi Komunal ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.
- ☐ Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta.
- ☐ Komiteti për Komitetet ka mbajtur 6 mbledhje.
- ☐ Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, ka mbajtur 2 mbledhje.
- ☐ Komitetit konsultativ Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka mbajtur 1 mbledhje.
- ☐ Komitetit konsultativ për Arsim Kulturës Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka mbajtur 3 mbledhje.
- ☐ Komitetit konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë, ka mbajtur 2 mbledhje.
- ☐ Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, ka mbajtur 3 mbledhje.
- ☐ Janë hartuar 39 procesverbale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komitetet, Komitetet Konsultative dhe debateve publike.
- ☐ Janë hartuar 31 vendime të ndryshme.

Krahasime:

Në vitin 2023 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë të realizuara 39 procesverbale dhe 31 vendime.

Në vitin 2022 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë të realizuara + 2 mbledhje solemne, 15 procesverbale dhe 26 vendime.

Në vitin 2021 gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë të realizuara 1 mbledhje solemne, 46 procesverbale dhe 19 vendime.

4. Sektori i Depos

Raporti i pranimit të mallrave apo Hyrje janë regjistruar 120 artikuj të ndryshëm në vlerë 20554.40€

Raporti i ngarkimit të mallrave apo Dalje janë regjistruar 851 artikuj të ndryshëm në vlerë 88,428.83€

5. Sektori i Autoparkut

	Gjashtmujori i parë 2023	Gjashtmujori i parë 2022
Kërkesa për vetura zyrtare	510 kërkesa	294 kërkesa
Kilometra të kaluara	76760 km	52626 km
Karburante të shpenzuara	6470 litra	4216 litra
Norma mesatare e shpenzimeve	8.4 litra	8.0 litra
Sigurim dhe regjistrim te veturave	3993.41 eur	3753.84 eur
Servisim dhe mirmbajtje te veturave	2475.5 eur	713.77 eur
Larja e veturave të administrates dhe QKMF-së	411.5 eur	221 eur

	Emri i makinës	Litra të shpenzuara	Kilometra të kaluara	Shpenzime për 100 km
1.	Kia Sportage 05-177-GF	1065 l/diesel	14239 km	7.4L/100 km
2.	Hyundai ix35 05Z-01-33	722 l/diesel	6290 km	11.4L/100 km
3.	Hyundai 05Z-04-33	842 l/diesel	14020 km	6.0 L/100 km
4.	Toyota Prado 05Z-05-33	462 l/diesel	3080 km	15 L/100 km
5.	Dacia Duster 05Z-10-33	892 l/benzinë	10273 km	8.6 L/100 km
6.	Dacia Duster 05Z-11-33	707 l/benzinë	7308 km	9.6 L/100 km
7.	Dacia Duster 05Z-12-33	929 l/benzinë	10034 km	9.2 L/100 km
8.	Autobus MAN 05Z-13-33	00 l/diesel	00 km	00 L/100 km
9.	Toyota Runer 05Z-15-33	181 l/diesel	1050 km	17.2 L/100 km
10.	Dacia Sandero 01-549-LP	670 l/diesel	10466 km	6.4 L/100 km
	Derivate me autorizim kositja e parkut te Komunes	20 l/benzinë	N/A	N/A
	Derivate me autorizim per udhetime zyrtare	21 l/diesel	N/A	N/A

6. Sektori i Arkivës dhe Transparencës

Numri i publikimeve në Ëeb-Faqen Zyrtare

Viti	Gjithsej	Dokumente	Lajme
2022	337	248	89
2023	531	413	118

Numri i Lëndëve të Procesuara përmes SMAED-it

Nga datë 02.05.2023. Sistemi është jashtë funksionit momentalisht dhe nuk mund të gjenerohet raport për dhënat e arkivës, ndërsa nga ASHI kemi marrë përgjigje që janmi duke punuar rreth zgjidhjes se problemit që kishit për lëndët që nuk janë duke ardhur në SMAED.

7. SEKTORI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

Periudhë e gjashtëmujorit të vitit 2023 karakterizohet me aktivitete të shumta në fushën e teknologjisë informative si rrjedhojë e furnizimit të institucioneve komunale me disa pajisje të reja teknologjike. Mosfunksionimi i mirë i sistemit të Intranetit, posaçërisht në muajt e parë të vitit ka qenë një sfidë në vete edhe pse ky sistem mirëmbahet nga ASHI.

- **Furnizimi me kompjuterë të ri** : gjatë kësaj periudhe, institucionet komunale janë furnizuar me mbi dhjetëra kompjuterë, laptopë dhe monitorë të ri. Ne kemi bërë instalimin e këtyre pajisjeve nëpër drejtori të ndryshme dhe atë duke përfshirë: montimin, formatimin me sistemin operativ

Ëindoës 10, instalimin e të gjitha programeve përcjellëse, përditësimin e programeve si dhe kemi bërë bartjen e të dhënave nga kompjuterët e vjetër te kompjuterët e ri.

- **Shërbim të fotokopjuesve dhe printerëve:** lidhim dhe konfigurojmë-instalojmë nëpër kompjuterët e drejtorive dhe institucionet tjera (si p.sh. Administratë, QPS, QP,QKMF). Edhe pse kemi pakënaqësi të shumta me operatorin ekonomik i cili vazhdimisht neglizhon punën për furnizim.
- **Përkrahja teknike:** në kohë të vazhdueshme kemi dhënë përkrahjen zyrtarëve/shërbyesve civilë për të gjitha çështjet e Teknologjisë Informative (instalime të kompjuterëve, printerëve, tonerëve, antiviruseve, kabllimeve të ndryshme, ndërrimin e lokacioneve, përdorimin e softëereve të ndryshëm etj.), këtu përfshihen të gjitha objektet komunale. Janë riparuar mbi 10 kompjuterë të cilët kanë qenë të lënë anash për hudhje mirëpo i kemi kthyer në gjendje stabile përmes formatimit dhe funksionalizimit të pjesëve shtesë dhe mund të përdoren nga zyrtarët e komunës.
- **ËEB faqja komunale:** në kohë të vazhdueshme kemi bërë mirëmbajtjen e ËEB faqes zyrtare komunale dhe bëjmë përkrahje direkt zyrtarëve përgjegjës për furnizimin me shënime në ËEB faqen zyrtare. Një ashtu, kemi fotografuar aktivitete të ndryshme si *Homazhe pranë pllakës përkujtimore të Dëshmorëve Nuri Bushi dhe Xhemsedin Suma, Fotografim dhe video inqizim i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit, Fotografim pranë Shtëpisë së Kulturës për organizim të dy Prillit, Menaxhimin e Mbeturinave –Regullorja në diskutim, instalimi i Penaleve Solere Fotovoldaikë.*
- **Sistemet operative:** aty ku kanë lejuar mundësitë teknike të pajisjeve, është instaluar sistemi operativ Ëindoës 10 Sistemet operative Ëindoës 7
- **Rrjetet dhe sistemet telefonike:** të gjitha nevojat që paraqiten në rrjetin telefonik dhe centralet telefonike mirëmbahen nga ne e gjithashtu edhe të rrjetit të telefonave VoIP.

Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme

Natyra Kalisi

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për periudhën janar-qershor 2023, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, ka funksionuar kryesisht në tre (3) sektorë:

1. Sektori për buxhet dhe financa,
2. Sektori për të hyra dhe
3. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë periudhës gjashtë mujore kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimit sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715.00Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....1,702,823.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....465,000.00 €,
- Shpenzimet komunale96,500.00 €,
- Subvencione dhe transfere....100,000.00 €,
- Shpenzime kapitale985,392.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,715.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

1. Përpilimi dhe përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore, me zotimet dhe shpenzimet e parashikuara të mjeteve buxhetore sipas dinamikës së planifikuar për vitin 2023, nëpër të gjitha kategoritë ekonomike si: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione e transfere dhe investime kapitale,
2. Përgatitja e Pasqyrave Financiare për vitin 2022 dhe dorëzimi i tyre pranë Ministrisë së Financave,
3. Përgatitja e raportit final të konsoliduar dhe analitik i bilancit të gjendjes për vitin 2022 dhe publikimi i tij në ueb-faqen e Komunës,
4. Përgatitja e Raportit Financiar për periudhën janar-dhjetor 2022 dhe dorëzimi i të njejtit në Kuvend Komunal si informacion për rrjedhën e të hyrave dhe shpenzimeve gjatë vitit fiskal 2022,
5. Publikimi i Raportit Financiar janar-dhjetor 2022 në ueb faqen e Komunës në tri formate: ëord, excel dhe pdf,
6. Përgatitja dhe publikimi i raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit dhjetor 2022 dhe publikimi i të njejtit në ueb faqe të Komunës,
7. Përgatitja e raporteve për barazim me Thesarin për vitin 2022, si dhe raportin për periudhën janar-qershor të shpenzimeve për vitin 2023.

8. Përgatitja e raporteve mujore të të hyrave dhe shpenzimeve dhe publikimi i të njejtave në ueb faqe të Komunës,
9. Deklarimi në Thesar të obligimeve të pa paguara dhe ato kontraktuale të muajit dhjetor 2022 si dhe të obligimeve mujore janar-qershor 2023,
10. Përgatitja e Raportit Financiar për periudhën janar-mars 2023 dhe dorëzimi i të njejtut në Kuvend Komunal si informacion për rrjedhën e të hyrave dhe shpenzimeve gjatë kësaj periudhe,
11. Publikimi i Raportit Financiar janar-mars 2023 në ueb faqen e Komunës në tri formate: ëord, excel dhe pdf,
12. Përgatitja e propozim vendimit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 në shumë prej **115,005.39 €**.
13. Përgatitja dhe hartimi i raportit tremujor për ekzekutimin e buxhetit për periudhat: janar - mars 2022.
14. Përgatitja e raporteve mujore janar-qershor të punëve dhe aktiviteteve të Drejtorisë,
15. Auditorët nga Zyra Kombëtare e Auditimit kanë bërë auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të vitit 2022,
16. Është finalizuar raporti i ZKA për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2022 dhe përcjellja e të njejtut në Kuvend Komunal si informacion si dhe publikimi në ëeb faqe të Komunës,
17. Hartimi i planit të veprimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2022, përcjellja e të njejtut në Kuvend Komunal si informacion si dhe publikimi në ëeb faqe të Komunës,
18. Planifikimi i projeksionit të të hyrave vetanake për periudhën 2024-2026 dhe përcjellja e tyre në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
19. Përgatitja dhe alokimi i të hyrave për çdo muaj, në bazë të planifikimeve buxhetore për vitin 2023,
20. Përgatitja e raportit të monitorimit të projekteve kapitale sipas periudhave Q1 dhe përcjellja e të njejtut në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
21. Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor,
22. Përgatitja dhe alokimi i të hyrave indirekte nga gjobat në trafik nga TM1 në projekte kapitale në vlerë prej 11,381 €.
23. Pranimi i Qarkores Buxhetore 2024/01 nga MFPT,
24. Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe dorëzimi i të njejtës në Kuvend Komunal për miratim,
25. Mbajtja e tri dëgjimeve buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026.

26. Publikimi i procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 në ueb faqe të Komunës.

Në këtë periudhë raportuese janar - qershor 2023, nga të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore sipas kërkesave të parashtruara janë iniciuar procedurat duke u bërë zotimi i mjeteve në 802 urdhër zotimi për pagesa (UZP), pastaj është vazhduar me procedimin e tyre në formë të shpenzimeve dhe aprovimi i të gjitha shpenzimeve për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe vendimet e marra për shpenzime, prej të cilave përfundimisht me gjendjen e datës 29.06.2023, janë ekzekutuar në total pagesa në vlerë prej 298,324.31 € ku përfshihen kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, ndërsa shpenzimet për kategorinë ekonomike paga dhe shtesa të cilat menaxhohen dhe mbikëqyren nga MFPT-ja janë në shumë prej 798,609.53€.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2023 është në lartësi prej **3,349,715.00Euro**.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

Kategoritë Buxhetore	Buxheti sipas Ligjit nr. 08/L-193	Realizimi Janar- Qershor 2023	%
Paga dhe Shtesa	1,702,823.00	960,996.95	56.43 %
Mallra dhe Shërbime	465,000.00	177,869.89	38.25 %
Shpenzime Komunale	96,500.00	35,558.54	36.84 %
Subvencione dhe Transfere	100,000.00	57,258.08	57.25 %
Shpenzime Kapitale	985,392.00	29,439.15	2.98 %
Totali	3,349,715.00	1,261,122.61	37.64 %

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2023 është në shumë prej 560,121.00 €.

Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej për periudhën janar-qershor 2023 nga të hyrat direkte 165,032.38 € dhe paraqesin 29.4 % € e planit të të hyrave vetanake. Në bazë të drejtorive për periudhën janar-qershor 2023 kemi inkasuar këto të hyra:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ka inkasuar të hyra në shumë prej 3,337.00 €
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka inkasuar të hyra në shumë prej 109,260.52 €;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike ka inkasuar të hyra në shumë prej 6,332.20 €,
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka inkasuar të hyra në shumë prej 775.00 €,
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka inkasuar të hyra në shumë prej 13,624.44 €;
- Drejtoria e Urbanizmit ka inkasuar të hyra në shumë prej 22,299.12 €;
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në shumë prej 2,016.10 €
- Sektori i Shërbimeve Sociale në shumë prej 108.00 €,
- Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini dhe Sport ka inkasuar të hyra në shumë prej 7,280.00 €;

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- ☐ Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),
- ☐ Përgatitja e propozim vendimit për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 në shumë prej **115,005.39 €**.
- ☐ Alokimi i të hyrave të inkasuara për çdo muaj, duke u bazuar në planifikimet buxhetore.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë periudhës janar-qershor 2023 ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Gjatë muajit shkurt kemi pranuar faturat e tatimit në pronë dhe tokë, ndërsa shpërndarja e tyre është bërë gjatë muajve mars-prill 2023. Numri i faturave ka qenë 1730,
- Sipas dispozitave ligjore, pas pranimi të faturave të tatimit në pronë dhe në tokë, qytetarët kanë parashtruar 47 kërkesa për korrigjim ndaj certifikatës së pronës dhe 6 ankesa ndaj faturës së tatimit në pronë,
- Gjatë periudhës janar-qershor 2023 kemi arritur të lidhim marrëveshje për pagesën me këste të tatimit në pronë,
- Faturimi i tatimit në pronë dhe në tokë për vitin 2023 në komunën e Hanit të Elezit është 222,737.00 €, ndërsa totali inkasuar i tatimit në pronë dhe tokë për periudhën janar-qershor 2023 është 99,409.52 € apo 44.6% nga planifikimi duke përfshirë borxhet, kamatën dhe ndëshkimet nga vitet e kaluara.

Drejtores e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Lindita Ballazhi

DREJTORIA PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE SPORT

Nr	Koha	Aktivitetet e punës	Përshkrimi
1	Janar	1. Takim Informues me maturanët rreth punës praktike, si bashkëpunim me zyrën e punësimit 2. Përfitues i projektit “Take” nga Caritasi Zvicerian 3. Janë pajisur shkollat me materiale sportive 4. Takim informues si bashkëpunim me SharrCem dhe organizatën Up To Youth 5. Vashdon programi i digjitalizimit në shkolla me Platformën e-Shkollori.	1. Takim informues për maturanët rreth punëve praktike që bizneset ofrojnë për të rinjtë 2. Projekti përfshinë kompletimin e një hapësire në IP “Ardhmëria” me lodra didaktike dhe inventar, një hapsirë me standarte për fëmijë. 3. Janë pajisur shkollat me materiale sportive, duke përfshirë dyshekë, shpatullore, rrjeta, granulat, litarë dhe pajisje gjimnastikore e shumë pajisje shpenzuese si topa, riketa etj. 4. Tema e takimit informues “Orientimi në karrierë dhe shkollimi profesional” 5. Mbahen trajnimet për platformën e-Shkollorin.
2	Shkurt	1. Subvencionim për botimin e dy librave. 2. Rregullimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ngrohjes qendrore. 3. Përgaditja e dy projekt propozimeve për Kforin Polak 4. Aktivitete sportive për nderë të ditës së pavarësisë së Kosovës 17 Shkurt 5. Manifestim qendror për 17 shkurtin. 6. Marrveshje me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit	1. Subvencionim për dy libra nga shkrimtarët Fadil Curri dhe Shaban Çupi 2. Rregullimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ngrohjes qendrore në SHFMU “Ilaz Thaçi”. 3. Propozimi i parë ka të bëjë me kërkesën për Vynil tek IP “Ardhmëria” dhe propozimi i dytë, ndriqimi për sallën sportive në SHFMU “Ilaz Thaçi”. 4. Organizohet turnir në futsall dhe Mundje. 5. Koncert kushtuar 17 shkurtit. 6. Për furnizimin e bibliotekave me libra.
3	Mars	1. Marrveshje bashkëpunimi dhe Caritasin Zvicerian 2. Fitues në projektin 3 vjeçar me IPKO Foundation dhe KEC 3. Donacion nga USAID 4. Përfitues të projektit nga Bashkimi Evropian (BE) 5. Takim informues me të rinjë 16-24 vjet për punë praktike në biznese	1. Përfitues të projektit TAKE ku kemi kompletuar një klasë për fëmijët 3-4 vjeq tek IP “Ardhmëria” nga ky projekt komuna ishte bashkëfinancues i projektit me 30%. 2. Jemi përfitues në projektin 3 vjeçar me IPKO Foundation dhe KEC për projektin “Veprimi Kundër Diskriminimit për të gjithë”. 3. Kemi pranuar Libra në vlerë monetare 400€ nga USAID lodra për fëmijë për institucioni parashkollor, ku idetë ishin kryesisht nga rinia e qytetit në bashkëpunim me DKA; 4. Përfshihen Ashensorë, staza hyrëse dhe nyje sanitare për fëmijët me nevoja të veqanta. 5. Punë praktike në biznese dhe profesione të ndryshme.
4	Prill	1. “Drejt malit” projekti nga MASHT 2. Aktivitete kushtuar ditës së Tokës. 3. Rregullimi i infrastrukturës teknike tek qendra Kulturore	1. Projekti “Drejt Malit” nga MASHT për Skijim me 20 nxënës nga klasat e 7-ta. 2. Mbjellja e fidaneve në shkolla dhe pastrim i hapësirave të qytetit nga nxënësit e shkollave. 3. Rregullimi i vintillit të prurjes së ujit dhe lidhjes së gjeneratorit.

5	Maj	1. Realizimi i garave regjionale në volejball 2. Zhvillim profesional për edukatore 3. Ligjerata për nx e klasave 6-9 4. Shënohet dita e Pikturës 5. Mështetja e OJQ-ve Kulturore, Sportive, Rinore dhe të tjera. 6. Subvencionimi i studentëve	1. Realizimi i garave nga Federata e sportit shkollor ku nikoqir ishte Komuna jonë. 2. Fuqizimi i sistemit shëndetsor dhe përmirësimi i gjendjes së ushqyerjes në fëmijëri të hereshme dhe moshave shkollore nga UNICEF. 3. Bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe DKA-Së 4. Mbahen gara në pikturë 5. Subvencione për OJQ 6. Me ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve, këtë vit kemi mbështetur 40 studentë si përfitues të bursave.
6	Qershor	1. Inagurimi i parkut SHML “Drdania” 2. Projekti Drejt Malit nga MASHT 3. Shënohet dita Olimpikë 4. Punoti 3 ditore me nxënësit e SHML “Dardania” 5. Festivali Folklorik Mbarkombëtar Hani i Elezit 2023	1. Realizimi i projektit YENI 2. Hikingu me 100 nxënës dhe pedagog të sportit. 3. Bashkëpunim me Komitetin Olimpik, MKRS dhe Federatën e Sportit Shkollor. 4. Bashkëpunimi me Up To Youth 5. Për herë të parë mbahet festivali folklorik mbarkombëtar 3 ditore në Han të Elezit.

Raporti i Bibliotekës 2023

Për çdo vjet Biblioteka Komunale në Han të Elezit si dhe këtë vit Ministria e Kulturës ka dhuruar 857 eksemplar më 10.05.2023.

Ka pasur dhurim të Librave edhe nga autor të tjerë:

- 1.21.03.2023 Sherife Shabani ka dhuruar bibliotekës Hani i Elezit 10 eksemplar
2. Shoqata e Kosoves per belbëzim dhuroj 4 kopje të librit 14.02.2023
- 3.16.03.2023 Fari bushi dhuroj 1 libër me titull “Qeverisja e korporatave (Sharrcem) në Han të Elezit”.
4. 24.03.2023 USAID dhuroj 18 libra Bibliotekës Komunale Hani i Elezit

1. FONDI I LIBRAVE NË BIBLIOTEKËN AMË

Në gjuhën	Shqipe	Serbe	Turke	Të tjetra	Gjithsej
	6113	14	22	334	7373

Vërejtje: Numri i lexuesëve ka qenë i reduktuar për shkak të klasifikimit të librave si dhe renditja nëpër raftet.

	Autori	Titulli	Viti	Nr.eks	Verejtje
--	--------	---------	------	--------	----------

1	Ministria e Kulturës	<u>Tituj të ndryshëm</u>	<u>2023</u>	<u>857</u>	Librat e Dhuruara nga Ministria e kulturesë 10.05.2023
2	Sherife Shabani	<u>Tituj të ndryshëm</u>	2023	10	Librat e Dhuruara nga Sherife Shabani 21.03.2023
3	Shoqata e Kosoves per belbezim	<u>Tituj të ndryshëm</u>	2023	4	14.02.2023 Shoqata e Kosoves per belbezim
4	Fari Bushi	Qeverisja e korporatave “Sharrcem”ne Han të Elezit	2023	1	16.03.2023 Fari Bushi dhuroj
5	24.03.2023 USAID	<u>Tituj të ndryshëm</u>	2023	18	24.03.2023 USAID

Raporti për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Hanit të Elezit

		Kulturë
		Identifikimi , ruajtja, mbrojtja dhe prezantimi i Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Hanit të Elezit
1	17.02.2023	Manifestimi i 17 shkurtit, u shënua 15 vjetori i Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u përuruan edhe shkronjat e UÇK-së. Në përmbyllje të manifestimit me program kulturo artistik nga “SHKA Sharri” si dhe me këngëtar mysafir.
	26.02.2023	Komuna e Hanit të Elezit shënoi ditën e Dëshmorëve dhe rënjes heroike të veprimtarit Gafurr dhe Driton Lokut, si dhe për nder të 26 Shkurtit ditës së krismës së pushkës të parë në Puset e Nikës dhe Veprës së lavdishme të UÇK-së.
	18.03.2023	Bashkësia Islame realizoj një aktivitet hatme të gjinisë femnore këtu në Qendrën Kulturore “Imri curri” Hani i Elezit
	28.03.2023	29 Mars-Dita e SHFMU “Ilaz Thaçi” , bashkëpunim me DKA-në. Ku pati një program kulturor me nxënësit e kësaj Shkolle.
	22.03.2023	Komuna e Hanit të Elezit në bashkëpunim me kompanin “Sharr Cem” kanë realizuar një aktivitet me nxënësit e klasës së parë dhe të dytë mbi rëndësin e ujit dhe ruajtjen e tij “22 marsi Dita botrore e Ujit”.
	26.03.2023	Tribun fetare për qytetarët e Komunës së Hanit të Elezit., KBI (Kshilli i Bashkësisë Islame) nga Hani i Elezit në bashkëpunim me grupin e Ilahistave nga Shkupi Nusret

		Kurtishi dhe stafin e tij. Në krye me Hoxhen e Nderum Musa Vila pati ligjirata dhe ilahi Fetare.
29.03.2023		Dita e shkollës “Ilaz Thaçi” u realizua me nxënësit e kësaj Shkolle një program kulturor, në Qendrën Kulturore “Imri curri” Hani i Elezit.
		Takime me Institutin Arkeologjik të Kosovës rreth relikteve të gjetura në vendbanimet e komunës së Hanit të Elezit dhe mundësia e hulumtimit të mëtejme në pronën e identifikuar.
10.04.2023		Komuna e Hanit të Elezit dhe Shoqata për kthimin e Shqipëtarëve të Shpërngulur nga trojet e veta dhe Shoqata e poetëve “ABC” organizuan Manifestimi përkujtimor 24 vjetorin të Holokaustit Shqipëtar “Bllaca 99” manifestimi u përcjell me poezi nga poetët të nryshëm me poezit e tyre. Pati edhe program kulturo artistik me ansamblin shtetëror “Shota” dhe shoqërin kulturo artistike “Sharri” nga Hani i Elezit.
18.04.2023		Dita Ndërkombëtare e Tokës me aksion pastrami, pjesë e aktiviteteve ishin edhe stafi Komunal, Drejtorët e Shkollave, mësimdhënës dhe nxënës, si dhe qytetar të tjerë. Shkolla e Mesme “Dardania” nga Hani i Elezit patën një takim me nxënësit e saj lidhur me përkujdesjen e si ta ruajm ambientin. Krahas këtij aktiviteti u realizua edhe një program kulturor me nxënësit e Shkollës së mesme me një monolog dhe një skeq.
10.05.2023		10 Maj; Dita e SHML “Dardania” në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës U shënuar kjo ditë me një program Kulturor me nxënësit e kësaj Shkolle.
20.05.2023		20 maji shënon ditën e pikturës, një prej formave të artit me nxënësit e shkollave fillore, është bërë nën përkujdesjen e Drejtorisë së arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, nga drejtoria për kulturë u ndan mirënjohje për gjithë nxënësit pjesëmarrës, pati edhe shpërblime modeste u ndan për vendin e parë vendin e dytë dhe vendin e tretë.
		Qershor java Kulturore
01.06.2023		Nji Qershori- u shënuar dita e fëmijëve me institucione para Shkollore klasët e ulëta të shkollave fillore, për të cilët u dha shfaqje teatrale “prallë për fëmijë” si dhe performua nga maskota me figura të ndryshme, ky aktivitet u realizu në bashkëpunim me kompanin “Sharr Cem” në Qendrën Kulturore “Imri Curri”.
02.06.2023		Dhurim Gjaku-Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin e gjakut në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit dhe Bashkësin Islame –dega e Hanit të Elezit organizuan aktivitetin e dhurimit të gjakut. Ky aktivitet për dhurim e gjakut është realizuar te Qendra e Kulturës “Imri Curri”
05.06.2023		Ora Poetika “Poezia s’njeh kufi- Bllaca dhe Eksodi 99” ky manifestim është realizuar për të dytën herë në Qendrën Kulturore “Imri Curri” ku performuan poezi të ndryshme me poetë nga trojet mbarë shqipëtare, po një ashtu pati edhe nxënës me poezit e tyre nga Shkolla e Mesme “Dardania” Hani i Elezit. Ky manifestim u përkujdes nga shoqata e Shkrimëtarëve ABC-ja nga Shkupi në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit, përkatësisht Drejtorin për Kulturë, Rinë dhe Sport.
06.06.2023		Në kuadër të ditëve të kulturës në sallën e Qendrës së Kulturës “Imri Curri” u shfaq performanca teatrale “Me këngët e Rizah Bllacës” me artistët nga Teatri Kombëtar, Interpretuan: Xhemal Gllavica, Rabie Kryeziu dhe Armend Ballazhi regjia Zana Duraku.
08.06.2023		Për nder të Ditës së Çlirimit në kuadër të javës kulturore u zhvillua turnir në futboll të vogël, nga data 2 qershor deri më 8 qershor, turniri ishte me karakter garuesë, në finale u

		takuan KF “Kuka” dhe “Ramadan Elezi,” Fitues i turnirit ishte ekipi. KF Ramadan Elezi.
09.06.2023		FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTARË HANI I ELEZIT –2023 NATA E PARË. Ishte edicioni i parë në Komunën e Hanit të Elezit me karakter garues,në këtë natë more pjesë 7 ansamble me performime të ndryshme tradicionale nga trevat e tyre.Nga Kosova, Shqipëria,Mali i Zi dhe nga Maqedonija Veriore.ky Festival synohet të bëhet tradicional. Hapja e Festivalit bëhet nga: -SHKA “Sharri” Hani i Elezit dhe -Ansambli “Qendra Kulturore “ – Kaçanik 1.AKV “ Bresana”-Opoj 2. SHKA” Shqiponjat e Drenicës”- Drenas 3. AKV “ Zëri i Kosovës”- Fushë Kosovë 4.SHKA” Duflla” Rashqe - Saraj 5. SHKA” Maja e Karajfilit”Vuthaj”- Mali i Zi 6.AKV” Kastriotët”- Ferizaj 7.SHKA” Jeta e re “- Sllupqan
10.06.2023		FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTARË HANI I ELEZIT –2023 NATA E DYTË. Ishte edicioni i dytë në Komunën e Hanit të Elezit me karakter garues,në këtë natë more pjesë 7 ansamble me performime të ndryshme tradicionale nga trevat e tyre. 1. SHKA” Tingujt e Vendlindjes”- Stagovë 2. AKV” Drenica“ – Skenderaj 3. SHKA “Zëri i Kamenicës” – Kamenicë 4. SHKA “Zëri i Luginës” – Bujanoc 5. AKV “Përparim Tomëqini” – Peshkopi
11.06.2023		FESTIVALI FOLKLORIK MBARËKOMBËTARË HANI I ELEZIT –2023 NATA E TRET. Ishte nata finale ku morrën pjesë 8 Ansamble Kulturo dhe shoqëri kulturo artistike, pati edhe këngëtarë musafyr, pas përfundimit të edicionit u ndan edhe çmimet,për vendin e parë,të dytë të tretë si dhe pati çmime të tjera Performuan: 1.SHKA “Bajram Curri” – Prishtinë 2.AKV “Deqani” – Deqan 3. SHKA “Malësori” – Gjonaj 4. SHKA “Shotë Galica“ – Drenas 5.AKV “Kemajl Aziai” – Viti 6. SHKA “Jahi Hasani” – Çegran 7. SHKA “Dibra e Madhe” – Dibër Maqedonia Veriore 8. SHKA “Shqiponjat” - Saraj
23.06.2023		Në Qendrën Kulturore “Imri Curri” në Han të Elezit, Stafi i Foshnjorjes për fund të këtij viti me nxënësit e sajë parashkollorë organizuan një program kulturorë. Teknikisht e ndihmuan stafi i Qendrës Kulturore“Imri Curri”

		Sport
--	--	--------------

16.02.2023	Më këtë datë është mbajtur turnir në mundje për nder të Pavarësisë së Republikës së Kosovës Klubi i mundjes “Dardania”-Hani i Elezit nën përkuajdesin e Federatës të mundjes dhe Komitetit Olimpik të Republikiës së Kosovës. Pati Klube nga Roajoni.
	Nën përkuajdesjen e Drejtoris për Arsim, Kultur,Rini dhe sport,është bërë sanimi i dëmtimeve në fushën e sportit “Ilaz Thaçi”në paralelën e Fshatit Seqishtë.
14.04.2023	SHMFU ”Ilaz Thaçi”garat regjionale në Futsall I mbajtur në Kaqanik u shpall kampion në konkurencën e meshkujve dhe do të përfaqësojn regjionin e Ferizait në Garat Republikane. SHML”Dardania” zuri vendin e dytë.
	Qershor
06.06.2023	Pë nder të Ditës së Çlirimit u mbajtë Turniri Ndërkombëtar në Mundje “TROFEU I PAQËS”, i organizuar nga Federata e Mundjes së Kosovës në bashkpunim me klubin e Mundjes “Dardania” nga Hani i Elezit. Turneu u organizua për grup moshat të nryshme, ku morrën pjesë 72 mundës nga Kosova dhe Maqedonia Veriore. (me karakter garuesë)
10.06.2023	Krosi (Vrapim) është sport tradicional për kategori të ndryshme, është realizuar gjat javës sportive të qershorit
	Qershor-sport me nxënësit
06.06.2023	Për nder të ditës së Çlirimit janë mbajtur gara shkollore në sporte të ndryshme gara në Badminton, gara në Shah, gara në Futboll, dhe gara në volejball, të gjitha këto aktivitete u mbajtën nëpër të gjitha Shkollat e Komunës së Hanit të Elezit, dhe ishin me karakter garues.
13.06.2023	U shënua Dita Olimpikë në Han të Elezit në bashkpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, MKRS, Federatën e Sportit shkollor të Kosovës dhe shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike të Han të Elezit. Në këtë ditë u organizuan aktivitete sportive duke promovuar vlerat olimpikë.
15.06.2023	Mbi 100 të rinjë nga Hani i Elezit, në kuadër të projektit “Drejt Malit” u nisën në hiking të cilët Përshkuan rrugën nga Hani i Elezit në drejtim të Lagjës Meliq për të kaluar kah Lagjja Kollomoqe drejt Kepit të Hisarit, dhe anasjelltas nën përcjelljen e Klubit “Alpin” Hani i Elezit.

	Rini
--	-------------

02.01.2023	Të rinjët e Hanit të Elezit këtu në Qendrën e Kulturës “Imri Curri” është mbajtur një aktivitet me nxënësit e klasëve të nënta me temën Orientimi në karrierë, e cila është mbështetur nga Organizata Rinore UP TO YOUTH.	
04.03.2023	KVRL-ja përfundon trajnimin”Youth Advocacy” tema e Ligjiratështe Shprehëja e mendimit kritik dhe ti aftësoj të rinjët për procese në vendimmarrëse.	
03.05.2023	Realizimi i projektit në SHMFU”Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë furnizimii zyrës në sale e sportit me kompjuter dhe furnizimin e kabinetit të informatikës me Laptopdhe videoprojektor, nga Fondi Japonez.	
27 04.2023	Ka pranuar donacion ,furnizim me paisje teknologjike për zyrën e KVRL-së ky projekt furnizohet për mes mbështetjes së fondit Qeverisë Japoneze.	
08.05.2023	Realizimi i projektit në SHMFU ”Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë furnizimi i sallës sportive me mjete Sportive.faza e dyt e projektit ishte kjo me donacion 710.00 € ky projekt furnizohet për mes mbështetjes së fondit Japonez.	

Drejtori për Arsim Kulturë Rini dhe Sport
Hisni Luri

DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

II PROJEKTET INVESTIVE KAPITALE

Në pajtim me buxhetin e Komunës për vitin 2022 dhe 2023 si dhe listën e projekteve kapitale të miratuar nga Kuvendi i Komunës, ka nisur realizimi i projekteve kapitale si më poshtë vijon:

1. Ka përfunduar faza e parë e punimeve në ndërtimin e parkut të qytetit në rrg. “Isa Berisha” në Han të Elezit si dhe kan filluar punimet në realizimin e fazës dytë. Vlera totale e projektit është 279,000€.
2. Për arsye të motit të paqëndrueshëm, me intenzitet më të ulët është punuar në asfaltimin e rrugës Lagjia Ramuk-Paldenicë (projekt i filluar vitin 2022- vlera e projektit 211,550€) si dhe rrugës te lagjia Ballazh-Pustenik (vlera e projektit 58,919€).
3. Është në përfundim e sipër kryerja e punimeve të ndërtimit të aneksit për këmbësor në urën e Seqishtes. Ky projekt është financim i ambasadës Japoneze dhe vlera e projektit është në shumë prej 32,000€.
4. Janë proceduar për tenderim projektet kapitale:
 - a. Ndërtimi i parkut në rrg. Lepenci. Vlera e projektit është 87,000€,
 - b. Ndërtimi i mureve mbrojtëse në zonat urbane dhe rurale. Vlera e projektit është 65,000€,
 - c. Ndërtimi (rihapja dhe zgjerimi) i rrugëve në zonat rurale. Vlera e projektit është 60,000€.

Punimet në realizimin e këtyre projekteve pritet të nisin në fillim të muajit korrik.

Po ashtu jemi përfitues të grantit në shumë prej 230,000€ nga Ministria e Infstrukturës për realizimin e projektit të zgjerimit të rrugës te kufiri (një pjesë e autoudhës dhe rrg. 11 Qershori) si dhe grantit në shumë prej 30,000€ nga MAPL për projektin e parkut në rrg. Lepenci.

Përveq kësaj, Drejtoria e Urbanizmit në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm ka hartuar dy projekte ideore të cilat kan të bëjnë me dy mbikalimet mbi hekurudhë në Han të Elezit:

1. Mbikalimi në afërsi të qerdhes së qytetit. Vlera e projektit është në shumë prej 1,147,004€,
 2. Mbikalimi në afërsi të fushës së futbollit dhe terminalit doganor. Vlera e projektit është në shumë prej 1,175,870€.
- Më poshtë po japim listën e projekteve investive kapitale si dhe statusin e tyre momental:

Lista e projekteve investive kapitale për vitin 2023 në kuadër të DUKMM

EMRI i PROJEKTIT	FINANC	BUXHE	PUNË	STATUSI	KOH
------------------	--------	-------	------	---------	-----

	UESI i PROJEKTIT	TI	KRYE SI	MOMENTAL I PROJEKTIT	ËZGJATJA
Rregullimi i parkut ne rrugen “Isa Berisha”	Komuna MAPL	279,000	Murseli Comp ani	Para përfundimit (faza e dytë 20,000€)	2022 2023
Ndërtimi i parkut te rrg. Lepenci	Komuna MAPL	87,000		E tenderuar	2023
Renovimi i objektit të Komunës	Komuna	60,000		Në fazën e para tenderimit	2023
Ndërtimi i aneksit për këmbësor në urën e Seqishtes	Ambasada Japoneze	44,000	Murseli Comp ani	Para përfundimit	2022 2023
Asfaltimi i rrg. Lagjia Ramuk-f. Paldenicë	Ministria e Infrastrukturës	216,000	Rahovica Comp ani	Para përfundimit	2022 2023
Asfaltimi i rrugës Goranc-Krivenik	Komuna	132,905		Është hartuar projekti detal	2023 2024
Shtrim me kubëza betoni në zonat urbane dhe rurale Hani Elezit	Komuna	50,000		Në fazën e para tenderimit	2023
Rregullimi i kanalizimeve neper zonat urbane dhe rurale te Hanit te Elezit	Komuna	60,000		Projekti është në fazën paratenderuese	2023
Ndërtimi (rihapja dhe zgjerimi) i rrugëve në zonat rurale	Komuna	60,000		E tenderuar	2023
Rregullimi i shtigjeve per këmbësor dhe qiklistë përgjat lumit Lepenc: UjiThart-Kaqanik	Komuna	25,000		Së bashku me komunën e Kaqanikut kemi aplikuar pranë UN-Habitatit dhe MAPL-s.	2022 2023
Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc	Komuna	5,000		Banka Boterore ka miratuar realizimin e projektit.Në pritje të vendimit të Qeverisë	2022 2023 2024 2025
Fabrika e ujit nga ujësjells i Dimces, shtëpia e kulturës, stadiumi i qytetit-shpronësim	Komuna	15,000	MMPH	Është dorëzuar elaborati i shpronësimit MMPH	2023
Ndërtimi i mureve mbrojtëse	Komuna	65,000		E tenderuar	2023
Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në zonën urbane rrg. Adem Jashari dhe f. Paldenicë	Komuna	40,000		Në fazën e hartimit të projektit	2023
Ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojrave në f. Gorancë	Komuna	20,000		E tenderuar	2023
Vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në rrg. “Nuri Bushi”	Komuna	5,000			2023 2024
Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në rrg. “Adem Jashari”, Udha e Shkronjave, “Driton Loku”-	Komuna	15,000		Në fazën e hartimit të paramasës dhe parallogarisë	2023

Paldenicë					
Rregullimi i varrezave të Qytetit	Komuna	20, 000		Në fazën e hartimit të paramasës dhe parallogarisë	2023
Ndërtimi i mbikalimeve në rr. “Martirët Bushi” dhe rr. “Lepenci”	Komuna	7,096		Janë hartuar projekte ideore për dy mbikalime	2023 2024 2025
Mjete të lira për bashkëinvestime	Komuna	40,000			2023

Shënim: Në listën e projekteve kapitale janë paraqitur vetëm projektet me kod 66480 Planifikimi Urban dhe Inspeksioni dhe jo projektet e tjera të cilat janë në listat e Drejtorive tjera.

III LEJET NDËRTIMORE

Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar 7 aplikime për leje ndërtimore dhe janë dhënë 2 leje ndërtimore ndërkaq për 5 aplikues të tjerë janë caktuar kushtet ndërtimore. Në raport me gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar është rritur numri i aplikuesve për leje ndërtimore.

Regjistri i lejeve ndërtimore të dhëna në gjashtëmujorin e parë:

1. Ylber Berisha, Kategoria I, sip. 212.4m² - taksa kom. 212.40€,
2. “Guri i Bekuar”sh.p.k. Kategoria II, impiant për prodhimin e gëlqeres, taksa për pagesë 22,141.45€ (pagesa në gjashtë këste. Të paguara dy këstet e para në shumë prej 11,513.56€).

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, nga taksa komunale për leje ndërtimore janë realizuar të hyra në shumë prej 11,725.96€ apo 9742.20€ më shumë se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

V SHFRYTËZIMI I TOKËS NDËRTIMORE DHE OBJEKTIT BANESOR (NDËRTESA E TË VETMUARVE) PRONË E KUVENDIT KOMUNAL

Sa i përket shfrytëzimit të tokës pronë e Kuvendit të Komunës si dhe shfrytëzimit me qira të objektit banesor (ndërtesa e të vetmuarve) po ashtu pronë Komunale nuk ka asnjë ndryshim në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Edhe më tutje janë 23 shfrytëzues me kontratë të tokës pronë e Kuvendit Komunal (ku janë të vendosura kryesisht lokalet me karakter të përkohshëm, garazhe etj.) si dhe gjashtë shfrytëzues të objektit banesor (banesa e të vetmuarve-pesë prej tyre për qëllime të banimit dhe njëri për lokal). Sipërfaqja e përgjithshme e tokës të dhënë me qera është 424.8m² ndërkaq sip. e banesave të dhëna me qera është 392.5m². Faturimi vjetor për shfrytëzuesit e pronës Komunale (tokës dhe banesave) është 6,042€. Përndryshe në periudhën Janar-Qershor 2023, Drejtoria ka inkasuar në emër të taksës për shfrytëzim të pronës Komunale shumën prej 2,109.84 € që është për 83.9% më shumë se periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

VI MBROJTJA E MJEDISIT

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë kryer 103 inspektime nga inspektorja e mjedisit lidhur me ndalimin e hedhjes së mbeturinave jashtë pikave grumbulluese, pengimin e hedhjes së mbeturinave inerte në natyrë, lum dhe prrocka, kontrollimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomik, gurëthyesve si dhe ndotësve tjerë të ambientit dhe aty ku është parë e arsyeshme janë bërë vërejtje me gojë si dhe dy gjoba mandatore. Sektori i Mjedisit në vazhdimësi ka monitoruar ndotjen nga “Sharrcem” ku së bashku me inspektorët e MMPHI-së kemi kryer inspektime dhe kemi dhënë vërejtje me procesverbal.

Sektori i Mjedisit duke u bazuar në Planin Lokal për Veprim në Mjedis – listën e aktiviteteve, ka shënuar Ditën Ndërkomtare të Tokës, Ditën Botërore të Ujit dhe Ditën Botërore të Mjedisit me një sërë aktiviteteve për pastrim, ligjerata vetëdijësuese me nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme, mbjellje drunjesh dhe lule etj. që japin mesazhe për mbrojtjen dhe ruajtjen e ambientit.

Emërtimi	VITI 2022	VITI 2023
Të hyrat nga Lejet Mjedisore Komunale	589.78€	0
Gjobat Mandatore të shqiptuara	100€	570€
Gjithsej	689.78€	570€

**VII
KA
DA
ST
RI**

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, është rritur numri i aplikimeve (kërkesave) për shërbime kadastrale nga 815 sa ishin në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar në 1041 sivjet ose 226 lëndë më shumë. Më poshtë po japim tabelën e lëndëve të realizuara gjashtëmujorin e parë të vitit 2023:

Raporti i lëndëve të kryera në gjashtëmujorin e parë 2023

Emërtimi i kërkesës	Numri i kërkesave	Pagesa
Qertifikata prone	418	1,166 €
Kopje plani	242	892 €
Bartje pronësie	104	2,920 €
Ndarje fizike të parceleve	22	1,300 €
Blerje të pikave	110	1,029,€
Bashkim të parceleve	8	160 €
Vërtetim që nuk posedon pronë	99	27 €
Modifikim pronësie	1	240€
Regjistrim hipoteke	2	300 €
Ç’regjistrim hipoteke	0	0.00 €
Historiat të parceleve	1	30 €
Regjistrim objekti (njësi banesore)	0	0.00 €
Korigjim të sipërfaqeve	16	40 €
Përgjigje në kërkesa për info. kadastrale	5	0.00 €
Kërkesë për heqjen e masës së përkohshme	0	0,00€
Kërkesë për barrë tatimore	3	0,00€
Kontrata për shfrytëzim të pronës Komunale	1	0.00€
Kërkesë për modifikim të atributëve të parceleve	3	40 €
Të tjera të ndryshme	11	40€
Taksa për shfrytëzim të pronës publike		2,109,84 €

GJITHËSEJTË:	1041	10,253.84 €
--------------	------	-------------

Në periudhën Janar-Qershor 2023 viti, Kadastri ka realizuar të hyra në shumë prej 10,253.84€ apo për 42.8% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

TË HYRAT E DREJTORISË PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2023

Të hyrat e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, në gjashtëmuorin e parë të vitit 2023 janë në shumë prej 22,549.80€ apo 118.8% më të larta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Të hyrat e drejtorisë për periudhën Janar-Qershor 2023

SEKTORI	Të hyrat 2022 viti	Të hyrat 2023 viti
Urbanizmi	2,435 €	11,725.96€
Kadastri	7,179 €	10,253.84€
Mjedisit	689 €	570€
Gjithësejtë D U K M M	10,303 €	22,549,80€

Drejtore i Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Nexhmedin Daci

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Duke u bazuar në Ligjin e Shëndetësisë së Kosovës si dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale i cili ka inkorporuar në tërësi konceptin e Mjekësisë Familjare duke e definuar atë si “formë themelore e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor, për individët dhe familjet e tyre”, KPSH në Komunën e Hanit të Elezit shërbimet shëndetësore i ofron në bazë të konceptit të Mjekësisë Familjare bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vazhdimisht jemi në përpjekje për realizimin e planit dhe objektivat të parashtruara në aspektin e cilësisë.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për performancën në:

- Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘‘ Dr.Menduh Kaloshi ‘‘
- Qendrën Për Punë Sociale
-

Aktivitete gjatë muajit JANAR-QERSHOR

- Më 31.01.2023 kemi pranuar donacion nga kompania Ipko: aparaturë Ultrazë me vlerë 12,000€.
- Rregullimin e disa filterave të ngrohjes në QKMF.
- Kam dërguar në ASHI një kërkesë për ndryshimin e sistemit të vijueshmërisë në punë në QKMF.
- Takim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Kolegjiun e Shëndetësisë.
- Kam përcjellur në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Shëndetësisë kërkesën për shtim të stafit në QKMF.
- Takim me organizatën Humanity First Kosova.
- Rregullimin dhe riparimin e rrjetit elektrik në objektin e QKMF-së.
- Ndrimin e sanitarisë në QKMF.
- Janë dhuruar 100 pako ushqimore familjeve në nevojë nga Arabia Saudite në bashkëpunim me organizatën Bereqeti.
- Janë dhuruar 300 pako ushqimore për familjet në nevojë nga organizata Qatar Charity.
- Me 20.04.2023 kemi bërë pranimin e donacionit nga kontigjenti i KFOR-it Italian të paneleve solare 12kË për kursim të energjisë elektrike në QKMF.
- Takim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Financave për sfidat lidhur me mungesë të stafit.
- Takim me Ambasaden e Anglisë lidhur me mekanizmin referues për parandalim të Ekstremizmit të Dhunshëm.
- Aktivitete edukativo-shëndetësore gjatë ditëve Ndërkombëtare të Shëndetësisë.
- Takim me Kolegjiun lidhur me reformat e politikave të Shërbimeve Sociale.
- Kemi mirëpritur një delegacion me përfaqësues nga shtete të ndryshme lidhur me shkëmbimin e përvojave rreth parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm.
- Takim me organizatën e KOMF-it dhe këshilltaren e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me gjendjen e QPS-ve në aspektin ligjor, institucional dhe funksional.
- Kanë filluar të punojnë stafi shëndetësor të përzgjedhur nga CARITAS, katër infermier dhe nja mjek I përgjithshëm.
- Është përzgjedhur mjeku pas përfundimit të procedurave të rekrutimit.
- Më 02.06.2023 në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut në Kosovë kemi mbajtur aksionin e dhurimit të gjakut ku janë regjistruar gjithsej 133 dhurues të gjakut.
- Takime me disa organizata vendore.
- Trajnim dy ditor me Asociacionin e Komunave me temat: “Politikat e Qeverisjes Lokale për Shëndetësi”
- Është bërë dezinfektimi i hapësirave publike në gjithë qytetin dhe fshatrave përreth.
- Janë shpërndarë 160 pako me mish për familjet në nevojë, 60 pako janë shpërndarë nga organizata Humanity First Kosova dhe 100 pako nga Qatar Charity.

• Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Menduh Kaloshi”

Kjo qendër ofron shërbime 24 orë në këto sektorë:

- Mekësi Familjare
- Barnatorja
- Sektori i Emergjencës
- Sektori i Diagnostikës
- Sektori i Shërbimeve Publike
- Stomatologjisë

Gjatë periudhës Janar- Qershor QKMF ka pasur këto aktivitete :

